



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash"

Universiteti Europian i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof As. Fisnik Kadiu

Dr. Julinda Keçi

Qershor /2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti" dhe
"Inxhinieri Strukturash"

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierise së Ndërtimitë, (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 630, datë 05.10.2018.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 221, datë 27.10.2022 (profili "Infrastrukturë Transporti").
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 61, datë 09.09.2022 (vetëm profili "Infrastrukturë Transporti", deri më 08.09.2025).
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli shtatë (7)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2024-2025: 8 PAE/3 PAK v.a 2023-2024: 6 PAE/3 PAK v.a 2022-2023: 5 PAE/2PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2024-2025: 61 studentë v.a 2023-2024: 25 studentë v.a 2022-2023: 15 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndertimi, me 2 (dy) profile studimi në "Inxhinieri Struktura" dhe "Infrastrukturë Transporti" ofrohet nga "Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimitë", në përputhje me ligjin 9741, datë 21.05.2007 të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimi nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë".

** Me VS nr. 17, date 21.11.2024 dhe VB nr. 10, date 11.12.2024, është miratuar riorganizimi i Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës në dy njësi bazë, Departamenti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit. Gjithashtu është miratuar mbyllja e Qëndres për Zhvillimin e Teknologjise dhe Inovacionin, si njësi baze e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikes dhe Arkitektures. Këto ndryshime janë miratuar nga MAS me shkresën me nr.7876/1 prot., datë 04.02.2025.*

Programi bazohet në një kurrikulë bashkëkohore, që ndërthur komponentin teorik me atë praktik; me theks të veçantë në zhvillimin e kompetencave teknike në *projektim strukturor, dhe analizë të infrastrukturës*. Lëndët janë të strukturuar për të nxitur të menduarin krijues të studentëve bazuar në metoda moderne mësimdhënieje me një infrastrukturë bashkëkohore laboratorike. Ai synon të pajisë studentët me njohuri të thella teorike dhe praktike në fushën e ndërtimit, duke i përgatitur studentët për tregun e punës, ashtu edhe për vazhdim të mëtejshëm në studime të ciklit të tretë, doktoratës.

Programi ka nisur zyrtarisht në vitin akademik 2018–2019, sipas Urdhrit të hapjes UMASR Nr. 630, datë 05.10.2018. Aktualisht është i akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 61, datë 09.09.2022, vetëm për profilin "Infrastrukturë Transporti", siç është konfirmuar me shkresën nr. 96 prot., datë 20.04.2021. Ndryshimet e mëvonshme në kurrikulë, të miratuara nga institucionit me Vendim Senati Nr. 5, datë 20.09.2022 – përfshirë ofrimin pa profile – nuk janë miratuar nga MAS. Gjithashtu, programi ka ndryshuar departamentin përgjegjës me vendim të MAS (shkresa nr. 7876/1 prot., datë 04.02.2025).

GVJ vlerëson Programin e Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në përputhje me standardet e kriteret akademike për të përgatitur specialistë të kualifikuar në fushën e ndërtimit. Ai mbështetet nga një staf akademik me përvojë dhe një infrastrukturë mësimore dhe laboratorike sipas kërkesave që shtron koha. Vlerësohet gjithashtu edhe për përshtatshmërinë e tij ndaj zhvillimeve të tregut të punës dhe nevojave të sektorit ndërtimit e infrastrukturës së transportit në Shqipëri.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, ka rregjistruar në datë 01.03.2024, kërkesën e IAL, Universiteti European i Tiranës me shkresë Prot.Nr.105, datë 29.02.2024 për akreditimin periodik të Programit të Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi” me profile “Inxhinieri Strukturash” dhe “Infrastrukturë Transporti”. Ka përcaktuar afatet dhe grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ), bazuar në kompetencat profesionale për fushën e studimit në këtë program studimi, eksperiencia e tyre në vlerësime të programeve të studimit të ngjëshme, integritetin profesional dhe shmangjen e konfliktit të interesit; për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim e në vlerësim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof Asoc. Dr. Fisnik Kadiu dhe Dr. Julinda Keçi dhe koordinatore teknike në ASCAL, Znj. Rajna Lila.

Nëpërmjet koordinatores teknike të ASCAL, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm i janë vënë në dispozicion materialet udhëzuese për funksionimin e grupit, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e antarëve të grupit për t’u fokusuar në vlerësimin e standardeve dhe plotësimin e kriterëve të programit të studimit në Universitetin European të Tiranës.

GVJ, mbështetur në udhëzimet e ASCAL, hartoi një plan pune për siguruar të gjitha informacionet e nevojshme gjatë vizitës vlerësuese në Institucion si dhe afatet për realizimin e tij. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ ka hartuar një seri pyetjesh, të cilat kanë ndihmuar në qartësimin e disa problematikave, që lidhen me përgatitjen e draf raportit.

Në datat 03 dhe 04.04.2025, GVJ organizoi takime sipas programit të përcaktuar nga QSCAL me drejtues të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, GVB, stafin akademik e studentët; takim me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Sekretarinë mësimore, me zyrën e NJSBC e kurikulave, Burimet njerëzore, Kërkimin shkencor dhe një vizitë në mjediset e universitetit, Bibliotekën dhe laboratorin e testimeve të materialeve të ndërtimit, efciensën e energjisë etj. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara më 03.04.2025 dhe 04.04.2025, në kujdesin e koordinatores teknike të ASCAL, Msc. Rajna Lila.

GVJ, është përpjekur të bëjë një vlerësim objektiv të të gjitha kërkesave për çdo standard dhe kriteret e tyre të paraqitura në këtë raport, duke besuar se informacioni i përgatitur do të ndihmojë bordin e akreditimit për të marrë një vendim të drejtë dhe objektiv.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të konkluzioneve të mbledhura dhe të diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.61 datë 09.09.2022 janë:

Rekomandimi 1.

Institucioni, të marrë masa që, ngarkesa mësimore e këtij programi studimi të mbulohet të paktën 70% nga personeli akademik me kohë të plotë, si edhe të shmangë angazhimin në këtë program studimi të personelit akademik jo në përputhje me fushën e ekspertizës, pa tituj dhe grada, sikurse parashikohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Përmbushet plotësisht nga institucioni

Në bashkëpunim me departamentin përkatës, është realizuar një planifikim për rekrutimin e stafit të kualifikuar dhe me eksperiencë, duke përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi. Për tre vitet e fundit akademike 2022–2025, mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi akademik të programit të studimit është si më poshtë, duke treguar plotësimin e rekomandimit.

Mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Në orë	568	284	733.5	264.5	944	178
Në %	67%	33%	73%	27%	84%	14%

Rekomandimi 2.

Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi, sipas rekomandimeve specifike të grupit të vlerësimit të jashtëm në Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

- Rekomandohet shtimi i lëndëve të profilit dhe reduktimi i orëve dhe krediteve të lëndëve si Aplikime të avancuara të fizikës teknike.
- GVJ rekomandon shtimin e krediteve të lëndëve të profilit si Ura dhe Tunele, Dysheme rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale, dhe ulje e krediteve në lëndë të tjera jo thelbësore për Specialitetin si Aplikime të avancuara të fizikës teknike.

GVJ. Përmbushet plotësisht nga institucioni

Është bërë rishikim i kurrikulës në përputhje me sugjerimet e ekspertëve të jashtëm dhe kërkesat e tregut të punës. Janë rritur kreditet për lëndën “Ura dhe Tunele” nga 5 në 8 ECTS, ndërsa është

hequr lënda “Aplikime të fizikës teknike”. Janë shtuar gjithashtu lëndë të reja si GIS dhe përpunimi i të dhënave.

Rekomandimi 3.

Institucioni, të marre masa për sigurimin e infrastrukturës të nevojshme laboratorike dhe të programeve kompjuterike, të dedikuara për kete program studimi.

GVJ, Përbushet kryesisht nga institucioni

Janë identifikuar nevojat për përmirësim të bazës laboratorike dhe është punuar për të përmirësuar bazën kompjuterike përmes bashkëpunimit me Zyrën e Projekteve dhe Administratën e Universitetit. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është transferuar në një ambient të Ish-Instituti i Ndërtimit, por ende nuk është plotësisht funksional, duke sjellë vështirësi logjistike.

Rekomandohet të funksionalizohet sa më parë laboratori dhe të hartohet një plan i qartë për seancat laboratorike, duke garantuar akses të rregullt për studentët.

GVJ, vlerëson se kjo zgjidhje mund të jetë e përkohshme, pasi me përfundimin e punimeve të ndërtimit të korpusit të ri të UET edhe ky konstatim do të zgjidhet.

Rekomandimi 4.

Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e këtij programi studimi, lëndët me zgjedhje për studentët.

GVJ, Përbushet plotësisht nga institucioni

Pas njoftimit të MAS se programi nuk mund të ofrohej pa profile dmth pa iu nënshtuar procesit të riorganizimit, u aktivizuan profilet "*Inxhinieri Strukturash*" dhe "*Infrastrukturë Transporti*". Plani mësimorë në Inxhinieri ndërtimi përfshin edhe lëndë me zgjedhje si "*Hartografi*" dhe "*Normativa të Projektimit të Elementëve të Strukturave Beton- arme*" për studentët Inxhinieri Ndërtimi, profili "*Inxhinieri Strukturash*" dhe "*Dyshemetë rrugore, hekurudhore dhe aeropurtuale*" dhe "*Restaurime dhe Përforcimi i Strukturave*" për studentët "*Inxhinieri Ndërtimi*", profili "*Infrastrukturë transporti*".

Rekomandimi 5

Institucioni, të marre masa që, praktikat mësimore që studentët e këtij programi studimi që realizojnë, të jenë të frutshme dhe efektive.

GVJ, Përbushet plotësisht nga institucioni

Është rritur numri i marrëveshjeve me institucione partnere për zhvillimin e praktikave profesionale. Studentët kanë realizuar praktika në institucione publike dhe kompani private ndërtimi. Janë mbajtur evidenca të praktikave dhe vlerësime mbi efektivitetin e tyre. Nga takimi me GVB dhe studentët zhvillimi i praktikave profesionale dhe përfitimet në funksion të tyre kanë

qenë dhe janë efektive, veçanërisht me krijimin e profilit “Inxhinieri Struktura” të këtij programi studimi. Një pjesë e studentëve janë punësuar në kompani të ndryshme pas përfundimit të praktikës profesionale, si p.sh. Jona Lici, Ervin Zani, Kended Lleshaj, Fabjola Bali, Anisa Mustafa, etj.

Rekomandimi 6

Institucioni, nëpërmjet njësive administrative përgjegjëse për këtë program studimi, të marrë masa që, dosjet e personelit akademik të jenë të plota si edhe të shmangen korrigjimet në regjistrat theme/tare të studentëve.

GVJ, Përbushet plotësisht nga institucioni

Dosjet janë të përditësuara sipas kriterëve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në Sekretarinë e institucionit, u kontrollua dosja e pedagogut S.M, pedagog i lëndës “Mekanika e dherave, themeleve dhe shkëmbit”, viti akademik 2023-2024 dhe 2024-2025, e cila rezultoi e plotë dhe pa korrigjime.

Rekomandimi 7

Institucioni, të përcaktojë kriterë të qarta për pranimin e studentëve në këtë program studimi, me qëllim, që studentët të kenë formimin dhe njohuritë e duhura për të ndjekur këtë program studimi.

GVJ, Përbushet plotësisht nga institucioni

Jane marrë masa dhe përcaktuar kriterë të qarta për pranimet në programin Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile, “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti” ku mund të pranohen studentë që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve në fushat Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Hidroteknike, Inxhinieri Gjeoteknike dhe Mjedisore, Inxhinieri e Mjedisit, Inxhinieri e Infrastrukturës, Inxhinieri Gjeodezike e Topografike dhe Inxhinieri e Transportit, si dhe fusha të tjera të ngjashme me këto. GVJ, vlerëson punën e institucionit gjatë aplikimeve dhe pranimeve të studentëve duke asistuar ndihmë për çdo kërkesë të kandidatëve, të cilat na u konfirmuan edhe gjatë takimit me specialistë të zyrës pranimeve.

Rekomandimi 8

Institucioni, të shohë mundësinë e lehtësimit të ngarkesës mësimore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi me qëllim këtë të fundit, të kenë kohën e nevojshme për tu angazhuar në veprimtari shkencore e publikime në revista me faktor impakti, në fushën e inxhinierisë.

GVJ, Përbushet plotësisht nga institucioni Është bërë planifikimi i ngarkesës mësimore brenda normave kontraktuale për vitet 2023–2025. Personeli akademik gjatë këtyre viteve akademike ka pasur ngarkesë mësimore të planifikuar brenda normës së parashikuar në kontratë dhe brenda kufirit të lejuar.



7

Rekomandimi 9

Institucioni, te pasqyroje dhe perditesoje fondin e literatures fizike dhe elektronike ne funksion te ketij programi studimi.

GVJ, Përbushet plotësisht nga institucioni

Institucioni ka përditësuar literaturën elektronike dhe është në proces të vazhdueshëm të përmirësimit të literaturës fizike.

Më datë 02.06.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 14/21 Prot., Datë 02.06.205, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 161/4 Prot, Datë 09.06.2025.

Bazuar në shkresën nr. 161/4, datë 09/06/2025 "Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 161/3, datë 02/06/2025", për procesin e akreditimit për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile Infrastrukturë Transporti dhe Inxhinieri Strukturash, GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, vlerëson aftësitë, eksperiencën dhe profesionalizmin e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, si dhe mirëkupton shpjegimet e dhëna nga Institucioni.

GVJ konkludon si më poshtë:

Nr.	Standarti/kriteri	Komenti i paraqitur nga institucioni
1	Standarti IV.2, kriteri 3	Gvj e mere në konsiderat komentin e institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport.
2	Standarti IV.3, kriteri 4	Gvj e mere në konsiderat komentin e institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport.

Bazuar edhe në relacionin e paraqitur nga Institucioni, konstatojme një reflektim të Institucionit në lidhje me rekomandimet e dhëna dhe biem dakord me komentet e paraqitura.

Grupi i punës:

Prof. As. Fisnik Kadiu

Dr. Julinda Keçi

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profile “Infrastrukturë Transporti” dhe “Inxhinieri Strukturash”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me profile në “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti”, i ofruar nga “Departamenti të Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me misionin e UET. Programi synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe përgatitjen e specialistëve të kualifikuar profesionalisht në fushën e teknikave të inxhinierisë së ndërtimit, në përputhje me standardet Evropiane. Programi i studimit synon kualifikimin dhe ngritjen profesionale të studentëve në fushën e inxhinierisë së ndërtimit me profile “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti”, ruajtjen e identitetit institucional dhe krijimin e një mjedisi të sigurtë, të qëndrueshëm dhe promovon vlerat kombëtare akademike e kulturore shqiptare. Këto të dhëna GVJ i verifikoi edhe gjatë vizitës në IAL, ku vlerësoi se ato i plotësojnë standardet për këtë program studimi. <i>Ref. Nr 2, Statuti i Universitetit UET.</i>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ, vlerëson se programi i studimit është hartuar në përputhje dhe ofrohet në zbatim me qëllimet e misionin e “Statutit dhe Planit strategjik të UET”, me theks në rritjen e numrit të specialistëve të kualifikuar, produktivë dhe kompetentë; të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare, me kontribut në ngritjen e cilësisë së jetës shoqërore, bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. Misioni i institucionit është “ofrimi i programeve të studimit me karakter profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, me profile “Inxhinieri Strukturash “ dhe “Infrastrukturë Transporti”.</p> <p><i>Ref. Nr2, Statuti i Universitetit UET, Ref. Nr 3, Plani Strategjik i Universitetit UET” viti 2024-2025.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Nisur edhe nga kërkesat e tregut të punës vendas, por edhe kërkesat e vendeve në Bashkimin Evropian për specialistë në fushën e strukturave dhe infrastrukturës së transporteve, përputhet plotësisht me misionin e “Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimitë”, që menxhon këtë program studimi; është i konceptuar dhe zhvilluar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të Universitetit UET dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në vendin tonë dhe protokollin evropian të Bolonjës e Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve. GVJ, vlerëson se programi i studimi nxit zhvillimin lokal e kombëtar, sepse është në plotësim të kërkesave të tregut vendas dhe të huaj. Përgatitja e këtyre studentëve me nivelin e kërkesave që shtron sot koha në fushën e materialeve novatore, të projektimit të strukturave, të teknologjive të reja në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës së transportit; u mundëson studentëve thellim të njohurive profesionale dhe kualifikim të mëtjshëm për të ardhmen. GVJ, vlerëson se programi i studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profiler ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me drejtimet akademike të Universitetit UET.</p> <p><i>Ref. Nr. Statuti i Universitetit UET; Ref. nr.3, Plani Strategjik i UET; Ref. Nr.4, “Plani Strategjik për zhvillimi e programit të studimit”, Ref.nr.5, Rregullore e UET.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile, në “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti”, është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, duke synuar në përafrimin e tij me prioritetet e vendit tonë. Në stadin aktual të zhvillimit të vendit dhe</p>

<p>globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>të transformimit të tij drejt sfidave të BE, në arsim, investimeve në ndërtim dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi, GVJ vlerëson se ky program studimi, me një staf akademik dhe specialistë të aftë të fushës, bashkëpunues me institucione vëndase dhe të huaja, si dhe duke patur parasysh mbështetjen e biznesit, përgatit inxhinierë ndërtimi të aftë mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. Studentët janë të përfshirë në studime e kërkime akademike, kualifikime të vazhdueshme. Staf i mësuesor i integruar në mësimdhënie e kërkimin shkencor dhe në kualifikim të vazhdueshëm, janë garanci për rritjen e standardeve të mirëqënies dhe zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><i>Ref.Nr. 2, "Statuti i Universitetit UET"; Ref. Nr.14, "Kurrikula e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi".</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ, vlerëson se Programi i studimeve Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me dy profile në "Inxhinieri Struktura" dhe "Infrastrukturë Transporti" që ofrohet nga Departamenti i "Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimitë" pranë Fakultetit të "Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës" (FIIA) të Universitetit UET ; është në përputhje dhe në harmoni të plotë me interesat dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore e interesat strategjike kombëtare. Programi synon që specialistët e ardhshëm të jenë të përgatitur profesionalisht sipas kërkesave që shtron koha në "Inxhinierinë e Strukturave" dhe "Infrastrukturën e Transporteve".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një</p>	<p>GVJ, vlerëson se UET ka kapacitetet e nevojshme logjistike dhe didaktike për të realizuar me sukses programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" në dy profilet e tij. Auditorët/Klasat e leksioneve e seminareve, biblioteka dhe laboratorët informatikë dhe ato të testimit të materialeve të ndërtimit</p>

<p>programi studimi në atë fushë.</p>	<p>dhe të efikasitës energjike në banesa. Personeli Akademik në nivel departamenti që aktivizohet për programin e studimit në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile, “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti” për vitin akademik 2024-2025, sipas Tabelës 12.3 përbëhet nga 1(PAE) Prof. Asoc. Dr; 5 (PAE) Dr; 2(PAE) MSc; 1 (PAE) Prof. Dr; 1 (PAK) Dr. dhe 1 (PAK) MSc.</p> <p><i>Ref. Nr. 02, Tabelat përmbledhëse, Tabela 1, 2, 11 dhe 12.3 Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, viti akademik 2024-2025.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Objekti i programit të studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profilet e tij, është në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Fakulteti është njësi kryesore akademike, i cili koordinon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. “Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës” është njësi bazë që koordinon programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profilet e tij në “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti”. Programi i studimit që ofrohet aktualisht është në përputhje me përcaktimet e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”, Vendimi i Këshillimit të Ministrave Nr.310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.31, “Për procedurat në lidhje me kodifikimi e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p><i>Ref. Nr. 2, “Statuti i Universitetit UET; Ref. Nr. 31.3, Njoftim mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit në UET.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore,</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e studimit të programi të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profile “Inxhinieri Struktura dhe Infrastrukturë Transporti”, është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të “Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës” si njësi bazë, pranë Universitetit UET (Manuali i Frascatit). Programi i studimit në Master i Shkencave, sipas kornizës së kualifikimeve shqiptare, klasifikohet si një kualifikim i nivelit 7. Ky Departament jep diplomë universitare në nivelet Bachelor dhe Master në përputhje të</p>

të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	plotë me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me Procesin e Bolonjës në Evropë dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjeshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Universiteti UET organizon konferenca dhe ofruan trajnime profesionale të çertifikuara me ekspertë vendas dhe të huaj. Nga ana e tij, Departamenti i mundëson këto trajnime jo vetëm për studentët aktualë që vazhdojnë studimet por edhe atyre të diplomuar ndër vite në UET ose edhe në të tjera IAL. Për t’u vënë në dukje është organizimi nga Universiteti UET i kurseve profesionale për “Auditues energjistik në ndërtesa”, “Vlerësues të pasurive të Paluajtshme” dhe “Ekspertizë hartografike dhe Ligjore në Kadastër”. GVJ këto të dhëna i verifikoi nga dokumentacioni i GVB si dhe nga takimet e zhvilluara me studentë dhe stafin akademik gjatë vizitë vlerësuese në institucion.</p> <p><i>Ref.Nr.33, Të dhëna për trajnimet profesionale; Ref.Nr.5, Rregullore e UET; Takimet e GVJ në Institucion.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se, kapacitetet institucionale të UET janë në përputhje me kurrikulën e programit të studimit dhe me standardet e udhezimet evropiane për arsimin e lartë, të përcaktuara nga Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitektures si njësi kryesore, i cili bashkërendon mësimdhënien e kërkimit shkencor që ai ofron. Universiteti UET, si institucion i arsimit të lartë zhvillon sipas një program të detajuar trajnime me partnerë ndërkombëtarë dhe specialist të spikatur në fushën e projekteve të ndërtimit dhe infrastrukturës së transporteve. UET prej disa viteve është organizator i kurseve/trajnimeve profesionale për “Auditues energjistik në ndërtesa”, “Vlerësues të pasurive të Paluajtshme” dhe “Ekspertizë hartografike dhe Ligjore në Kadastër”.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
Standardi I.3				
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>		<p>Programet e studimit në “Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitektures”, janë programe të hartuara në përshtatje me nevojat e shoqërisë shqiptare, kushtet aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. Njësitë administrative mësimore-kërkimore (departamentet) dhe njësitë kryesore (fakultetet) koordinojnë veprimtaritë e njësive bazë për mirëmbajtjen e infrastrukturës, pranimin, marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurimin e cilësisë dhe projektet. Institucioni nga ana e tij është garanti i kësaj marrëdhënie nëpërmjet ndarjes së detyrave midis njësive dhe stafit në përbushje të detyrave të tyre. Marrëveshjet aktive të bashkëpunimit në funksion të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” janë në rritje të vazhdueshme.</p> <p><i>Ref.5, Rregullore e UET; Ref. Nr.4, Plani Strategjik për zhvillimin e programit MSH në Inxhinieri Ndërtimi; Ref.34, Marrëveshjet e bashkëpunimit për programin master i shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile.</i></p>		
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>		<p>Përvoja e Universitetit UET është e pasur sa i takon marrëveshjeve të bashkëpunimit (40) me një numër të konsiderueshëm institucionesh si brenda ashtu dhe jashtë vendit, që për këtë program studimi ky zgjerim përfaqëson një objektiv strategjik të Universitetit UET, për të cilën është hartuar edhe strategjia e ndërkombëtarizimit në nivel institucional; ku është përfshirë edhe ky program studimi. GVJ, vlerëson marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe si brenda edhe jashtë vendit, ku një vend të konsiderueshëm e zenë ato për realizimin e praktikave profesionale të studenteve dhe me aktorë të tregut të punës për punësimin e studentëve.</p> <p><i>Ref.Nr4, Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit "Master i Shkencave", në "Inxhinieri Ndërtimi"; Ref.Nr.32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për program in e studimit dhe praktikat profesionale.</i></p>		

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Universiteti UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të fushës së programit të studimit për realizimin e internshipeve të studentëve. GVJ, vlerëson se nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve janë krijuar kushte e mundësi për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve të Universiteti UET, procedura të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar edhe procedurat që duhet të ndiqen por edhe roli i aktorëve dhe njësive të përfshira në këto bashkëpunime. GVJ vlerëson, që për zhvillimin e projekteve ndërkombëtare, UET i ka dhënë prioritet “Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve” me qëllim që të lehtësohet aplikimi në grande kërkimore. Gjithashtu, partneriteti me jashtë i Universitetit UET është mjaft efektiv edhe për marrëveshjet e lidhura për shkëmbim të stafit akademik dhe të studentëve, siç janë ato në projektet ERASMUS KA2 "Engineering curricula modernization in renewable energy in Albania Universities-ENGINE", ku UET prej vitit 2019 është partner.</p> <p><i>Ref. Nr. 28, Projektet e UET; Ref. Nr.28.1, https://uet.edu.al/en/inter-institution.al-agreement; Ref.Nr.28.2, https://uet.edu.al/active-projects; Ref.Nr.28.3 https://uet.edu.al/completed-projects; Ref.Nr.32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikave profesionale; Ref.Nr.32.1, Dokumenti B.1 “Mbi praktikën profesionale”;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Për analizën e ecurisë së këtij programi studimi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi në “UET”, njësia përgjegjëse harton raporte periodike për të analizuar arritjet dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Raporti vjetor nga Zyra e hulumtimit të projekteve vjetor përshkruan në detaje përfitimet nga marrëveshjet me institucionet kombëtare e ndërkombëtare; përfitimet për mobilitetin e studentëve dhe stafin akademik nga Zyra e Marrëdhënive Ndërkombëtare dhe punësimin e studentëve të diplomuar nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve.</p> <p><i>Ref. Nr.35, Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - Departamenti Inxhinierise dhe Arkitekture; Nga takimet e GVJ në Institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se UET bashkëpunon në mënyrë aktivisht me sektorin e biznesit të fushës së ndërtimit dhe institucione</i></p>



	<i>arsimore brenda dhe jashtë vendit. Universiteti UET, ka zgjeruar lidhjet me sektorin e biznesit për praktikat profesionale të studentëve ne programin Master i Shkencave “Inxhinieri Ndërtimi” si dhe mundësi internshipi e punësimi, vizita në kompani dhe pjesëmarrje të rregullta në Panairin e Karrierës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi”, është bazuar në rregulloren e “Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës” dhe përputhet plotësisht me misionin e Universitetit UET dhe udhëzimet e MARS, legjislacionin vendas në fuqi dhe sistemin Evropian të Transferimit e Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi bën pjesë në ciklin e dytë të studimeve 2 (dy) vjeçare, me ngarkesë mësimore vjetore 60 kredite ECTS dhe totali për dy vite 120 kredite ECTS. Nga tabelat e dokumentacionit dërguar nga universiteti UET, konstatojmë se lëndët janë vlerësuar me 6, 8 deri në 10 kredite ECTS, praktika mësimore 12 kredite ECTS dhe diploma me 18 kredite ECTS. <i>Ref.Nr.14.2. Plani mësimor i programit në gjuhën shqipe); Ref. Nr. 14.3 Plani mësimor i programit në gjuhën shqipe.); Ref. Nr.30, Dokumenti A.III Mbi parirnet e ndertimit të program it te lëndës</i>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile, është i fokusuar ka si objektivi formimin teorik dhe praktik të studentëve dhe pajisjen e tyre me njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara; për t’u përballur me sfida komplekse në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Njohuritë, që studentët marrin, janë të natyrave të ndryshme si p.sh. ato të komunikimit akademik, të menaxhimit, profesional etj. Aftësitë, ky program, është i fokusuar në kualifikimin profesional e shkencor të specializuar në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, strukturave dhe infrastrukturës së transporteve; Kompetencat, studentët fitojnë përgjegjësi nëpërmjet aftësisë dhe përvetësimit të Teknikave të reja digjitale në programet llogaritëse të strukturave të ndërtimit, Metodave të Testimit të Materialeve, Provave të Strukturave të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit. GVJ, vlerëson, që shpërndarja e orëve mësimore e pasqyruar në ndarjen sipas krediteve është e organizuar në mënyrë të tillë, që ruan raportin teori/praktikë.</p> <p><i>Ref. Nr.14.2, Plani mësimor i programit në gjuhën shqipe;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, ECTS. Ai realizohet në 2 (dy) vite akademike; ndërsa viti është i ndarë në 2 (dy) semestra me nga 60 kredite ECTS, semestri i parë dhe me 56 kredite ECTS, semestri i dytë. GVJ, vlerëson përmbajtjen e Programi të studimit me kërkesat dhe elementët e parapara nga ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe aktet e tij nënligjore. Programi mësimorë Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, është i përbërë nga paketa: A. “Lëndë bazë” (Metoda Kërkimi në Inxhinieri) me 6 ECTS; B. “Lëndë Karakterizuese” (Teoria e avancuar e strukturave 1 dhe 2, Konstrukione Speciale Beton Arme, Dinamika e strukturave dhe inxhinieria sizmike, Projektim Urbanistik 1, Ura dhe Tunele, Mekanika e Dherave, Shkembit dhe Themeleve, E drejtë mjedisi, GIS) me 64 ECTS; C. Lëndë Ndërdisciplinore/ Profili me zgjedhje “Infrastrukturë Transporti” (Hartografi, Gjeologjia e Aplikuar, Dyshemetë rrugore, hekurudhore dhe aeroportuale) dhe profili me zgjedhje në “Inxhinieri Struktura” (Konstrukione Beton Arme të paranderura, Normativa dhe projektimi i elementëve të strukturave Beton-Arme, Restaurimi dhe përforcimi i strukturave) me 20 kredite ECTS; D. Lëndë plotësuese (Praktika profesionale) me 12 kredite ECTS dhe E. Detyrime Përmblylëse (Punimi i Diplomës) me 18 kredite ECTS. Në total 120kredite ECTS.</p>

	<i>https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.; Nga takimet e GVJ në Institucion.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UET, është institucion jo-publik, që nënkupton se programi i studimit është i organizuar në përputhje të plotë me VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, referuar elementëve përbërës të programit të studimit për secilin profil studimi, tipeve të komponentëve dhe programit të lëndëve, përbëhet sa vijon: Lëndë bazë, A (6 ECTS, ose 5%); Lëndë Karakterizuese, B (64ECTS, ose 53.3%; Lëndë Ndërdisciplinore, C (20ECTS ose 16.7%; Praktikë mësimore, D 12 ECTS ose 10% dhe Detyrime përmbyllëse, E; (18 ECTS ose 15%). GVJ, vlerëson Universitetin (UET) për politikën e tij të hapur për pranimin e studentëve në përputhje me aktet nën ligjore në fuqi. Politikat e pranimin janë përcaktuar në rregulloret bazë dhe akte të tjera të brendshme, udhëzime “Për procedurat e

	<p>aplikimit dhe rregjistrimit në arsimin e lartë”, ndërsa financimi bazohet kryesisht nga të ardhurat e tarifave të studimit dhe projekteve ku departamenti është i përfshirë.</p> <p><i>Ref.Nr.5, Rregullore e përgjithshme UET; Vendimi KM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit”, e ndryshuar.</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencore në Inxhinieri Ndërtimi (cikli i dytë) ofrohet në të njëjtën fushë studimi, me përmbajtje të ngjashme dhe me të njëjtën emërtesë me të tjera IAL në vend. Ky kriter është i parashikuar në Pikën 6, Neni 86 "Kodifikimi i programeve të studimit" të Ligjit 80/2015. Nga vizita në institucion dhe takimi me GVB të këtij programi studimi, na u konfirmua një gjë e tillë e realizuar mbi 80%. Si rezultat i këtij procesi, vihet në zbatim kriteri ligjor që lidhet edhe me përafrimin e programeve të fushave të ngjashme me të njëjtën emërtesë, duke patur si element dallues kodin përkatës. Me përfundimin e studimeve studentët pajisen me Diplomë, e cila ju mundëson të marrin licensë profesionale nga Ministria e linjës sipas kriterëve të vendosura prej saj.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profile “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti”, bazuar në ISCED-F 2013, ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve të kodifikimit. GVJ, vlerëson këto arritje që lidhen me kodifikimin, e cila bën të mundur edhe plotësimin e kriterit e përafrimit të programit të studimit në fusha të ngjashme me emërtesë të njëjtë. Me miratimin e kodifikimit referuar fushës së studimit në Inxhinieri Ndërtimi, për pasojë edhe lëndët/modulet, që përbëjnë këtë program studimi janë të kodifikuara. Nga dokumentacioni i ardhur nga MASH si dhe takimet e organizuara edhe në institucion, GVJ verifikoi kodifikimin e këtij Programi studimi në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile, që rezultojnë 72MS0732S.</p> <p><i>Ref. Nr. 31.1, VKM Nr. 310, date 11.05.2022 "Per specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit."; Ref. Nr. 31.2, Shkresë MAS Udhëzim Nr. 31, datë 15.11.2022 "Për; procedurat e kodifikimit të programeve të studimit."; Ref.Nr.31.3, Shkresë UET, datë 31.03.2023 "Propozimet për kodifikimin e programeve të studimit"; Ref.Nr.31.4; Njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit.</i></p>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuara në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit trajton me hollësi sa vijon: Thellim i formimit të përgjithshëm mbi konceptet themelore, Rezultatet e të nxënësve, aftësitë dhe kompetencat, etj. Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri ndërtimi" me dy profile ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për çdo lëndë, praktikën profesionale dhe Tezëna e Projekt Diplomës. Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" shoqërohet me kodin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	"Departamenti të Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimit" menaxhon Programin e studimit Master Shkencor në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy vite akademike, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor. Rregullorja mësimore e programit të integruar, mbështetet në Ligjin. Nr 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Departamenti është njësi bazë e Fakultetit të "Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës" me Urdhër të Ministrisë Arsimit, Sporteve dhe Rinisë Nr. 529, datë, 04.09.2018. Ndërsa, UET është akredituar me Vendim të Bordit të

Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017 dhe pas riorganizimit me Vendimin Nr.46, datë 05.07.2019. GVJ, vlerëson që Institucioni dhe departamentet e tij i plotësojnë detyrimet ligjore jo vetëm për raportin (Udhëzimi i MAS nr.1, datë 14.01 2020), por dhe për nivelin e kualifikimit të personelit akademik, nxjerrë nga Tabelat 6.1/6.2 dhe 6.3; viti akademik 2022-2023 (PAE/PAK= 5/2); viti akademik 2023-2024 (PAE/PAK= 6/3) dhe viti akademik 2024-2025 (PAE/PAK=8/3). Përsa më lart, Njësia kryesore/bazë përgjegjëse e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile studimi në “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti” i përmbush detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi si për numurin e personelit dhe kualifikimin e tyre. Të drejtat dhe përgjegjësitë e çdo njësie janë të përcaktuara në aktet dhe rregullatoret e institucionit.

Të dhëna për Departamentin e Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimitë:

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	3	2	2	2	1
Prof. Asoc.	2	1	3	-	2	3
Dr./PhD.	4	4	3	5	3	3
Msc.	5	12	3	12	5	13
Totali	13	20	11	19	12	21

Referenca: Aneksi 80, Tabela 1 &2 (Personeli akademik me kohë të plotë dhe i ftuar); Raporti RVB; Shënime nga vizita në Institucion;

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin

Për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorët “Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimit”, Koordinatorin i përzgjedhur, janë përgjegjës për realizimin e praktikave mësimore. Krahas seancave që zhvillohen në auditore studentët sipas programit mësimorë në ciklin e dytë të studimeve,

<p>në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>janë të organizuar për kryerjen e praktikave në institucione, organizata ose shoqëri të mbikqyrur nga pedagogu i caktuar në rolin e këshilluesit të karrierës. Fakulteti i Inxhnierisë, Informatikës dhe Arkitekturës për realizimin e praktikave mësimore ka lidhur 25 marrëveshje me institucione dhe kompani në fushën e biznesit që përkrijnë edhe me fushën profesionale të këtij programi studimi. Praktikave profesionale mbikqyren nga një pedagog i stafit të departamentit dhe nga personi përgjegjës në kompaninë ku zhvillohet praktika.</p> <p><i>Ref. Nr. 18, Mbi praktikën profesionale, pjesë e Broshurës së Dokumenteve; Ref. Nr. 34.1 - 34.16 Marrëveshjet e bashkëpunimit;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjës për zhvillimin, ecurinë dhe mbarëvajtjen e objektivave të programit të studimit, departamenti ka caktuar si koordinator të këtij program studimi Prof.Asoc. S.S. (Vendim i Dekanit FIIA, Nr. 45/1, date 04/10/2022); detyra kryesore e të cilës është ndjekja në mënyrë të vazhdueshme e zhvillimit të programit dhe raportimi i rregullt tek drejtuesi i Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit. Në mënyrë më të detajuar këto detyra përfshijnë: shqyrtimin e programeve të studimit; materialet e nevojshme të lëndëve/bibliografi të përditësuara; miratimin e tezave të provimit dhe të detyrave të kursit; ndjekjen e zhvillimit të praktikave profesionale si bashkëpunimin me grupet e kërkimit. Të gjitha këto detyra janë të përcaktuara edhe në anekset, që lidhen me vendimin e emërimit të ashtu edhe në aktet e tjera e rregulloret e UET.</p> <p><i>Ref. Nr. 6, Dokumenti mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit; Ref. Nr. 36, Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se Departamenti i "Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit", është njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me dy profile; "Inxhinieri Struktura dhe "Infrastruktur Transporti". Departamenti i përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike që ai disponon, duke përfshirë stafin akademik, si ato me tituj akademik dhe gradat shkencore. Inxh. Gazmir Hallaçi, personelit akademik efektiv (PAE) është i angazhuar si kordinator për realizimin e monitorimin e studentëve, gjatë gjithë periudhës së praktikës deri në përfundim të studimeve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimitë si njësia bazë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, në ndihmë të së cilës është edhe Programi në Inxhinieri me profilin “Inxhinieri Strukturash” dhe “Infrastrukturë Transporti”. Edhe koordinatori i Programit të studimit, disponon informacionet e nevojshme, në lidhje me strukturën, përmbajtjen e programeve si në versionin hard dhe soft copy, pasi programet janë dorëzuar nga ana e personelit akademik që në fillim të semestrit. Plani mësimor përmban informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e organizimit të programit të studimit; semestrat në të cilin zhvillohen lëndët, lektorët e moduleve, llojin, objektivat dhe kohëzgjatjen e modulit, kreditet e moduleve të përcaktuara në ECTS, objektivat e modulit, metodat e vlerësimit, literaturën përkatëse, detyrimet e studentëve për çdo modul dhe detyrimet përmbyllëse. Plani mësimor është objekt i rishikimit në çdo vit akademik dhe pas diskutimeve të këtij plani, në department ai miratohet nga dekani i fakultetit. GVJ vlerëson rregulloren e programit të studimit, kurrikulën, planin mësimor, syllabuset e lëndëve dhe ndarjen e tyre sipas veprimtarive formuese. Lëndët janë të kategorizuara në: (A) Lëndë të formimit Bazë, të cilat japin përgatitjen metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; (B) Lëndë të formimit karakterizues, të formimit në fushën e programit të studimit dhe në disiplinën shkencore; (C) Lëndë ndërdisiplinore/integruese, me disa grupe disiplinash dhe grup lëndë me zgjedhje; (D) Lëndë plotësuese- gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale dhe (E) Detyrime përmbyllëse si punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm; nëpërmjet të cilave ndihmojnë në formimin e studentëve dhe aftësimin e tyre për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës. Këto informacione janë të disponueshme në faqen zyrtare të Departamentit të Arkitekturës dhe</p>

	<p>Inxhinieris së Ndërtimitë si dhe në “Planin Mësimor” në faqen kryesore të internetit të Universitetit UET.</p> <p><i>Ref. Nr. 5, Rregullore e UET, Neni 16, pika 16.2; Ref. Nr. 14, Kurrikula e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi;</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor specifikon gjithë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit, ai është i publikuar dhe i aksesueshëm për publikun. Llojet e lëndëve dhe pesha e tyre në planin mësimor janë në përputhje të plotë me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar. Përmbajtja e syllabuseve është e plotë duke patur detaje për vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda, emrin e titullarit të moduleve, llojin, objektivat dhe kohëzgjatjen e modulit, metodat e vlerësimit dhe literature e rekomanduar dhe atë të detyruar, përfshirë dhe detyrimet e studentit për çdo modul dhe detyrimet përmbyllëse. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me dy profile (viti 2024-2025) është i organizuar në dy semestra dhe ofron 16 (gjashtëmbëdhjetë) lëndë të shpërndara në dy semestra, me orë mësimore për çdo lëndë.</p> <p><i>Tabela 12.2 , programi mësimorë “Master i Shkencave” në Inxhinieri Ndërtimi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Mënyra e pranimit dhe seleksionimi i studentëve në programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” është e përcaktuar në rregulloren e Programit, pika 2, “Pranimi në programin e studimit”. Institucioni vendos kriteret për pranimin e studentëve në zbatim edhe të udhëzimeve nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë. GVJ, vlerëson se Institucioni në rregulloren e tij ka paraparë edhe transferimin e studimeve në të njëjtin cikël studimesh, procedurat e transferimit (D11), si dhe ekuivalentimin e programeve të studimeve për studentët që transferohen . Programi i studimit parashikon edhe rregullat transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve drejt IAL-ve të tjera. Gjatë vizitës në institucion, takimi me studentët, na u konfirmua prej tyre se informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, për lëndët, praktikat, seminarët dhe gjithë komponentët formues të programit të studimit kanë qenë të plota dhe të qarta.</p> <p><i>Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi; Ref. Nr. 27.2, Mbi transferimet, njohjen e</i></p>

	<i>krediteve dhe mobilitetin e studentëve; Nga takimet e GVJ në Institucion.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” pjesë e Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimitë, përmban gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me ngarkesën mësimore brenda dhe jashtë auditorit, syllabuset për çdo lëndë, kreditet sipas UET të shprehura në ECTS, përshkrimin dhe objektivat e kursit, tematika për çdo javë, literatura bazë dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metaodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjet e ECTS. Ato iu vendosen studentëve në dispozicion nëpërmjet sistemit LMS (Learning Management System). Syllabuset e lëndëve të programit të studimit janë pjesë e dosjes me dokumentacionin mbështetës që shoqërohet për këtë program.</p> <p><i>Ref. Nr. 39, Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës; Ref. Nr. 53.1, VKM Nr. 41, date 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", e ndryshuar.</i></p>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>Institucioni, para fillimit të çdo viti akademik shqyrton të gjitha programet e studimit, në mënyrë që këto të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ, mendon se Programi i studimit është i përshtatur dhe përputhet me nevojat e kërkesat e tregut të punës. Në hartimin e këtij Programi janë marrë për bazë edhe përvojat dhe eksperiencat e shkollave më në zë për kurrikulat e ngjashme në këtë fushë studimi, që mundësojnë formimin e specialistëve të rinj me teknikat e kërkesat që shtron koha. Institucioni para fillimit të vitit të ri akademik, ofron trajnime të vazhdueshme për stafin akademik me qëllimin përmirësimin e përmbajtjes së syllabuseve. Kurrikula e programit rishikohet çdo vit, duke bërë ndryshime nëse vlerësohet e nevojshme, sipas përqindjeve të lejuara nga statuti i Universitetit Evropian të Tiranës. Procedurat e rishikimit dhe të përmirësimit bëhen në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, Kreu IV neni 35, gjithmonë në bashkëpunim edhe me NJSBC. Në disa raste kërkohet edhe asistencë teknike e personelit akademik në varësi të programeve të studimit, duke mundësuar kështu edhe unifikimin e formateve të syllabuseve në nivel institucional.</p> <p><i>Ref. Nr. 52, Procedura për ndryshimin e kurrikulës.</i></p>

Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Departamenti i "Inxhinierisë dhe Arkitekturës" ofron një burim të pasur informacioni dhe dokumentacioni për programin e Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy profilet e tij, duke vënë theksin në organizimin dhe pasurimin e strukturës dhe përmbajtjeve të kurrikulës së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Përmbajtja e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" ofron një bazë të mjaftueshme njohurish në fushën e teknikës së inxhinierisë së ndërtimit. Në përfundim të programit të studimit, të diplomuarit fitojnë formimin e tyre teorik dhe kompetencën profesionale për tu përshtatur në sektorë të ndryshëm pune si atë publik dhe privat. Programi i studimit me dy profile "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash" është hartuar bazuar edhe në kërkesat e tregut të punës në vëndin tonë madje duke ju mundësuar studentëve punësim edhe në tregun evropian e më gjerë. Komponentët mësimorë janë në funksion të bashkëveprimit dhe interaktivitetit të studentëve dhe pedagogëve përkatës të lëndëve në funksion të stimulimit të tyre krijues/novator dhe praktik. Lëndët janë të organizuara në mënyrë të tillë që ofrojnë një raport bindës në thellim të njohurive e aftësive jo vetëm në fushat teorike por edhe në ato profesionale me synimin kryesor punësimin e studentëve. Referuar lëndëve mësimore, programi i studimit ka treguar se arrin të përmbush objektivat formuese të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Ref.Nr.5, Rregullore e UET; Nga takimet e GVJ në Institucion.</i></p>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e	GVJ vlerëson se programi i studimeve, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve iu mundësojnë studentëve njohuri, aftësi

<p>semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>dhe kompetencë në përmbushjen e objektivave akademikë të programit të studimit. Programi i studimit është i shtrirë në 2 (dy) vite akademik me 4 (katër) semestra. Studimet përmbajnë 120 kredite ECTS të shpërndara në çdo semestër në përputhje me legjislacionin në fuqi; justifikojnë rezultatet e pritshme të të nxënit dhe të kërkimit shkencor. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik kontribuojnë në arritjen e objektivave dhe kompetencave që ofron programi i studimit.</p> <p><i>Ref.Nr. 38, Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të programity; Ref.Nr.10.1 deri 10.3, kalendari akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Plani mësimor është në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave dhe i ndërtuar me përvojën më të mirë ndërkombëtare të programeve të studimit në Inxhinieri Ndërtimi. Gjatë vizitës dhe takimeve me stafin mësimor, GVJ vlerëson se në shumë lëndë aplikohen detyra/projekte kursi me studentët për të siguruar aftësi, kompetencë dhe formim të thelluar profesional. Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara raportet e formimit teori-praktikë të formimit profesional të studentëve dhe plotësimin e objektivave në tërësi për këtë programi. Gjuha e mësimit është gjuha shqipe.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar duke konsultuar edhe programe të ngjashme ndërkombëtare. Syllabuset e planit mësimor të programit të studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" parashikojnë kontrollin e dijeve të ndara nëpërmjet pjesëmarrjeve aktive në auditor, kryerjen e detyrave, provimeve të pjesëshme dhe provimit përfundimtar. Konceptimi dhe ndarja mes veprimtarive formuese synon që studentët të kenë mundësi mobiliteti dhe transferimi të studimeve, të konkurojnë dhe të përshtaten denjësisht dhe punësimin e tyre në kushtet e tregut. Natyra e moduleve dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të pjesës teorike dhe praktike për çdo modul.</p> <p><i>Ref. Nr. 19, Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Master I Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në</p>	<p>Syllabuset janë ndërtuar në përputhje me ligjin dhe pasqyrojnë informacione mbi lëndën, objektivat, synimet dhe kompetencat, konceptet themelore, tematikat e përfshira, format e kontrollit të</p>

<p>mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>dijeve, literatura, etj. Në rregulloren e programit të studimit është e përcaktuar, që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara tek studentët në përfundim të lëndës. Ato përditësohen çdo vit duke mbajtur parasysh që literatura kryesore e mbështetëse të jetë e viteve më të fundit. Nga takimi i GVJ me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, na u konfirmua se tekstet në përdorim nga stafi janë ato nga shtëpitë botuese më të njohura në botë si Oxford, Pearson, Cambridge, Sage etj, një pjesë e të cilat siguroheshin privatisht nga vetë stafi. Gjatë takimeve me Dekanin, Përgjegjës të departamentit dhe me stafin akademik, si dhe nga shqyrtimi i Syllabuseve të lëndëve mbizotëron tendenca, që literatura bazë dhe ajo e rekomanduar e përfshirë në Syllabus të jetë jo më e vjetër se 5 (pesë) vitet e fundit; por në bibliotekën e institucionit këto tekste mungonin në bibliotekë. GVJ u njoh edhe me vështirësitë që stafi has për sigurimin e literaturës së re të porositur në gjuhë të huaj; ashtu si edhe për të siguruar literaturë teknike specifike në gjuhën shqipe siç janë kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit apo të ashtuquajturat “Eurocode” etj.</p> <p><i>Ref.Nr.19, Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit-Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi; Ref. Nr.19.1, Formati i Syllabusit (shqip/anglisht)- VKM 41/2018; Ref.Nr.39, Dokumenti AIII, Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika 12.2;</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimit” përmban njohuri profesionale për aplikimin e teknikave të inxhinierisë së ndërtimit tradicionale dhe të avancuara si për materialet e reja të ndërtimit ashtu dhe projektimin e strukturave të veçanta dhe atyre me shkallë të lartë vështirësie. Programi i studimit MSH në “Inxhinieri Ndërtimi” mbështetet nga një staf akademik cilësor dhe shumë i përgatitur dhe me eksperiencë. Programi korespondon me Nivelin 7 të Kuadrit Shqiptar të AQF. Ai ofron njohuri të avancuara në inxhinierinë e ndërtimit duke synuar nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore dhe zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve inxhinierike e kërkim shkencor në këtë fushë. Në syllabuset e lëndëve, janë të reflektuara pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e përfitimit të dijeve, objektivi, synimet dhe kompetencat, që studentët përfitojnë me mbarimin e studimeve duke siguruar përvetësim të njohurive, aftësimin e plotë për zhvillim të karrierës dhe kompetencave për këtë nivel studimi. Programi</p>

	<p>përfshin kurse për zgjidhjen e problemeve, kërkimin dhe inovacionin në këtë fushë .</p> <p><i>Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me dy profile, neni 3</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Program i studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Ndërtimi” me profile në “Inxhinieri Strukturash” dhe “Infrastrukturë Transporti” i ofron studentit njohuri dhe dije bazë për formimin e duhur në këtë fushë. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë tek studentët një bazë shumë të mirë edhe për kërkimin shkencor, të nevojshme për ciklin e tretë të studimeve në doktoraturë si dhe punësim e integrim të shpejtë me kërkesat që shtron tregu i punës. Programi i studimit në “Inxhinieri ndërtimi” me dy profile “Inxhinieri Strukturash” dhe “Infrastrukturë Transporti” janë hartuar dhe realizohen konform misionit dhe qëllimit të institucionit, duke synuar në formimin e specialistëve me njohuritë dhe kompetencat që lidhen me këto dy profile. Në hartimin e programeve të studimit për këto dy profile është patur parasyshë perspektiva dhe kërkesat e tregut të punës në fushën e investimeve të ndërtimit dhe infrastrukturës së Transportit në Shqipëri.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se, Programi i studimit Master i Shkencës në “Inxhinieri Ndërtimi” në UET është përshtatur me kërkesat dhe standardet e tregut të punës. Bashkëpunimi i gjerë me institucione partnere, të diplomuar dhe aktorë të tregut të punës, programi ka siguruar një përmbajtje të pasur të lidhjeve të teorisë me praktikën në “Inxhinieri e Strukturave” dhe “Infrastrukturë Transporti” duke iu ofruar studentëve një bazë të fortë për formimin e tyre profesional. Përfshirja e studentëve në procese vendimmarrëse dhe vlerësimin e mësimdhënies, bashkëpunimet e shumta me specialistë të spikatur, ka siguruar një qasje pozitive për rritjen e cilësisë së programit mësimorë dhe përshtatjen e tij me nevojat dhe sfidat që shtron koha në hapsirën e tregut të inxhinierisë së ndërtimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” është hartuar nga stafi Akademik i Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës në Universitetin Europian i Tiranës duke përmirësuar dhe përshtatur përmbajtjen e programit më mirë me kërkesat e tregut të punës. Për këtë qëllim janë identifikuar pikat e forta dhe të dobta të programit të studimit duke përdorur të dhëna cilësore dhe sasore në konsultim edhe me bashkëpunorë dhe partnerë nga tregu i punës duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve që kanë kryer studimet; mbështetur gjithashtu dhe në mendimet e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës i ngritur në nivel Fakulteti. Gjatë vizitës në institucion GVJ vlerëson të dhënat e siguruar nga forumet e burimeve njerëzore në nivel fakulteti “UET HR Club”, i zhvilluar në vitin akademik 2023-2024 nga Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës me temë “Bashkëpunimi ndërmjet Aktorëve: Akademia, Biznesi, Qeverisja, Shoqëria Civile, si faktor vendimtar për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë” dhe në fillim të vitit akademik akademik 2024-2025 me temë “Përafrimi i rezultateve të të nxenit në akademi me kërkesat e industrisë: Një qasje bashkëpunuese”. Nga Zyra e Planifikimit të Karrierës së studentëve të Diplomuar gjatë takimeve na u tha se edhe Studentët janë pjesë e rëndësishme për përmirësimin e programit mësimor. Senati dhe NJBSC janë garant i përcjelljes së mendimeve dhe opinionëve nga studentët të diplomuar më parë, të cilët tashmë janë të punësuar në profesion në tregun e ndërtimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë mundur marrjen në konsideratë edhe të propozimeve nga bashkëpunorë e partnerë të interesuar në tregun e punës.</p> <p><i>Ref. Nr. 12.1, Bordi i Tregut të Punës i DIA; Ref. Nr. 12.3, Poster panairi i punës dhe HR CLUB 2022-2024; Ref. Nr. 29, Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi Ref. Nr. 38.1, Evidencë për mbledhjet e hapura me studentët; Ref. Nr. 52, Procedura për ndryshimin e kurrikulës;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime</p>	<p>Universiteti UET synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimarrëse të institucionit (sipas Statutit të UET studentët</p>

<p>studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>përfaqësohen në Senatën akademik dhe NJBSC me të drejtë vendimarrje). Studentët marrin pjesë në organet vendimmarrëse duke garantuar adresimin e të drejtave dhe shqetësimeve të tyre. Prej disa vitesh, Bordi i Tregut të Punës pranë departamentit ka në përbërje të tij anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët zhvillojnë karrierën e tyre profesionale në institucionet ku janë të punësuar. GVJ, vlerëson mbledhjet e hapura me studentët, që organizon departamenti një herë në muaj me studentët e programeve të tij. Në këto takime studentët kanë mundësinë të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të këtij programi studimi. Një politikë e tillë është prioritet i Planit Strategjik 2021-2025 të UET. Këto qasje nxisin një mjedis bashkëpunues edhe në përmirësimin e programit mësimorë.</p> <p><i>Ref. Nr.3, Plani Strategjik 2021-2025, Prioritetet në angazhimet në procesin mësimor, pika I; Ref. Nr.12.1, Bordi i Tregut të Punës i DIA; Ref. Nr. 29, Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi; Ref. Nr. 38.1, Evidencë për mbledhjet e hapura me studentët; Ref. Nr. 52, Procedura për ndryshimin e kurrikulës;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Për të përmirësuar dhe përditësuar programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile “Infrastrukturë Transporti”, “Inxhinieri Strukturash”, i licensuar dhe hapur në vitin 2018, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në Universitetin UET, bashkëpunon me rrjete sociale profesionistësh dhe institucione publike. GVJ, vlerëson përditësimin e Programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me profil “Infrastrukturë Transporti” edhe me profilin “Inxhinieri Struktura “për të reflektuar jo vetëm dinamikën e ndryshimeve të ndodhura në fushën e tregut të punës në ndërtim, por edhe për të adresuar rekomandimet e lëna nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit në akreditimin për herë të parë. Njësia e bazë përgjegjëse për këtë programi studimi dhe stafi akademik kanë bërë ndryshime jo vetëm në kurrikulën, por edhe përmirësime e përditësime në përmbajtjen e syllabuseve dhe literaturës respektive. Konsultimet kanë qenë gjithëpërfshirëse, në takime të vazhdueshme, ligjërata të të ftuarve dhe forumeve të hapura.</p> <p><i>Ref. Nr. 37, Evidencë për mbledhjet e hapura me studentët.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se, Programi i studimit Master i Shkencës</i></p>

	<p>në "Inxhinieri Ndërtimi" në UET, është përshtatur me kërkesat dhe standardet e tregut të punës. Bashkëpunimi me institucione partnere, të diplomuar dhe aktorë të tregut të punës, programi ka siguruar një përmbajtje të pasur të lidhjeve të teorisë me praktikën në profilet "Inxhinieri Struktura" dhe "Infrastrukturë Transporti"; duke iu ofruar studentëve përgatitje profesionale të mjaftueshme. Studentët janë të përfshirë edhe në procese vendimmarrëse dhe vlerësimin e mësimdhënies, dhe siguruar një qasje pozitive për rritjen e cilësisë së programit mësimorë dhe përshtatjen e tij me nevojat dhe sfidat që shtron koha në hapsirën e tregut të punës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>GVJ, vlerëson programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti", "Inxhinieri Strukturash" ku janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat e studimit dhe kërkimit shkencor, në përputhje me objektivat madhorë të strategjisë afatgjatë të zhvillimit të Universitetit UET. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Universitetit UET si p.sh. "Rregullore mësimore e Departamentit, janë përcaktuar objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor, pika 3.3 e Rregullores mësimore. Në mbështetje të këtij programi studimi puna kërkimore është konceptuar edhe nëpërmjet zhvillimit të lëndëve, përgatitjes së detyrave të kursit dhe gjatë përgatitjes së diplomës.</p> <p><i>Ref. Nr. 3.1, Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025, pika I .3; Ref.Nr.7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndeitimi, pika 3.3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike</p>	<p>Fakulteti Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës respekton lirinë akademike të stafit akademik bazuar në akte rregullatore të hartuara enkas për këtë qëllim. Autonomia dhe liria akademike janë të garantuara dhe bazohen në të drejtën ligjore dhe në Statutin e Universitetit UET si dhe Rregulloren e Përgjithshme të tij. Drejtimi i kërkimit shkencor në Fakultet realizohet nëpërmjet Qendrës për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit. Stafi i Fakultetit është i</p>

<p>të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>organizuar në Grupe Kërkimore e Shkencore dhe Personeli akademik gëzon liri të plotë për të organizuar veprimtari mësimore, kërkimore dhe krijuese. me stafin e departamentit, ndjekjen e aktiviteteve, asiston në takime dhe ndjek procesin e studimit lidhur me strukturën, orarin e kurseve etj. Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore të pedagogëve realizohet edhe në pjesëmarrjen në Konferencën shkencore, që organizohet çdo vit, i emërtuar “Ditët e studimit Shqiptar”. Gjatë takimit me stafin akademik, në nivel departamenti GVJ vlerëson punën për hartimin e planit vjetor të Kërkimit Shkencor, në të cilin janë të parashikuara edhe shpenzimet financiare të kërkuara. Plani financiar miratohet nga dekanati i Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.</p> <p><i>Ref. Nr. 43, Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit - Departamenti Inxhinierisë dhe Arkitekturës; Ref.Nr.55, Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH),2022-2024; Ref.Nr.55.2, Kalendari i Aktiviteteve 2024-2025;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit nxit dhe motivon studentët për pjesëmarrjen e tyre në kërkime shkencore, aplikimet për të cilat realizohen në mënyra të ndryshme si p.sh. realizimi i detyrave të kursit në terren duke krahasuar sipas kriterëve të kërkimit, strukturat b.a. për objektet ekzistuese me ato të detyrës së kursit të studentit. Një mënyrë tjetër është pjesëmërrja e studentëve në projektet e kërkimit shkencorë të pedagogëve që organizohet çdo vit, i emërtuar “Ditët e studimit Shqiptar” duke i nxitur të marrin pjesë. Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në bazë të rregullores cakton për mbikqyrerjen e studentëve në aktivitet kërkimore shkencore pedagogë me grada dhe tituj shkencor.</p> <p><i>Ref. nr.4, Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Ndërtimi"</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Financimi i veprimtarive kërkimore e shkencore në Universitetin UET realizohet nga kombinimi i burimeve të brendshme dhe të donacioneve/financimeve të jashtme. që menaxhohet nga një strukturë administrative e ngritur për këtë qëllim. Së pari, mbështetja kryesore financiare për fakultetet vjen nga vetë Universiteti European i Tiranës; Së dyti, nga të ardhurat e siguruara nga aktivitete të ndryshme, përfshirë bashkëpunimet me partner të jashtëm, donacione dhe financime nga projekte. Menaxhimi financiar dhe mbikqyrja e aktiviteteve kërkimore shkencore trajtohen nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve. UET për personelin akademik</p>

	<p>efektiv ofron grante për pjesëmarrje në konferenca, botimet në revista dhe përfundimin e titujve akademik. Të ardhurat që vijnë prej aktiviteteve të ndryshme administrohen nga institucioni dhe pasqyrohen në mënyrë transparente në bilancet e vitit, duke u bërë të aksesueshme nga fakultetet e interesuara.</p> <p><i>Ref. Nr.43, Te dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit- Departamenti Inxhinierisë dhe Arkitekturës.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi GVJ vlerëson përpjekjet e UET, në drejtim të përcaktimit dhe konsolidimit të misionit të tij institucional për studimet dhe kërkimin shkencor në përputhje me objektivat kryesore të tij. Njësia kryesore ka prioritet kryesorë bashkërendimin e veprimtarive në mësimdhënie, me veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të stafit të saj dhe fushën e studimit në "Inxhinieri Ndërtimi" duke mbështetur lirinë akademike të personelit akademik dhe në profilet e studimit në "Inxhinieri Struktura" dhe "Infrastrukturë Transporti"</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektiveve të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Njësia përgjegjëse Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, mbështet Stafin akademik në projektet kërkimore-shkencore të tyre, sipas temave/projekteve dhe profileve dhe angazhimin në bashkëpunime dhe partneritete në nivel lokal, rajonal dhe global. GVJ vlerëson kërkimet në fusha që, trajtojnë problematika dhe tematika me vlerë të Inxhinierisë së ndërtimit, me të cilat përballen shoqëritë urbane dhe në veçanti ato rajonale dhe lokale. Vënia në shfrytëzim e Laboratorit të testimeve të materialeve të ndërtimit dhe i efikasitetit të shfrytëzimit të energjisë, kanë krijuar kushtet për të filluar eksperimentime e kërkime shkencore në UET.</p> <p><i>Ref.Nr.43, Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit- Departamenti Inxhinierisë dhe Arkitekturës</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu	Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës mbështet dhe motivon stafin akademik për kërkimin shkencor dhe projektet.

<p>përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Praktika e deritanishme e stafit akademik tregon se pjesëmarrja e tyre në konferenca dhe publikimet e tyre është e mirë. Përveç stafit akademik angazhohen edhe studentët që kanë përfunduar ose që vazhdojnë studimet. Grupet drejtuese të PMK-ve janë një hallkë e rëndësishme për kontrollin e brendshëm të cilesisë së produktit shkencor pasi, ato vendosin për punimet që pranohen në DSSH dhe orientojnë kërkimin shkencor në Junior Researchers, që punojnë në PMK-të perkatese. Një nga evidencat e këtyre angazhimeve janë dhe mobilitetet dhe marrëveshjet e bashkëpunimeve në kuadër të programeve ERASMUS. Artikujt, punimet dhe pjesëmarrjet akademike në fund të çdo viti akademik janë të renditura në Raportin Vjetor të Departamentit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti si njësi bazë, organizon çdo vit Konferencën “Ditët e Studimeve Shqiptare” në muajt Prill-Maj, duke ndihmuar personelin Akademik dhe studentët në arritjen e objektivave në fushën e kërkimeve shkencore. Gjithashtu, çdo muaj organizohen edhe nga Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës konferenca, aktivitete shkencore, biseda të hapura me studentëve dhe personelin akademik. Në këto aktivitete stafi dhe studentët e diplomuar ndihen të angazhuar për të bashkëpunuar në prezantimin e publikimeve dhe të studimeve të tyre në Revistën shkencore “Ingenious”, nëpërmjet së cilës u jepet mundësia autorëve të publikojnë kërkimet e tyre origjinale në gjuhën angleze. GVJ, vlerëson angazhimin e përfshirjes së lektorëve të ftuar si një vlerë me rëndësi për shkëmbimin e ideve dhe metodave në mësimdhënie në faza të ndryshme procesit mësimorë.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile, është hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ekonomisë së tregut, me qëllim që të diplomuarit në Programin e studimit në “Inxhinieri Strukturash” dhe “Infrastrukturë Transporti” të formohet me njohuri të mjaftueshme për punësimin e tyre në studio profesionale me aktivitete projektimi; për përgatitjen e dokumentacionit ligjor në zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe supervizorë të objekteve, rrugëve e autostradave etj.; Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjensinë për efikasitetin e energjisë, Agjensinë Shtetërore të Kadastrës atë të Trajtimit të Pronave etj., si dhe institucione të tjera publike ose private, profesionist i lirë, jo vetëm në Shqipëri por edhe më gjerë pas akreditimit institucional nga QAA.</p>
	<p>(https://www.qaa.ac.uk/neës-events/news/european-university-of-tirana-secures-global-quality-accreditation)</p>


	<i>Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi.</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit në Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje të plotë me aktet nënligjore në fuqi dhe kërkesat e ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Me përfundimin e studimeve programi i studimit iu mundëson studentëve formim të kompetencave për marrjen e licencës profesionale për t’u pajisur edhe me licensë profesionale nga ministria e linjës sipas akteve ligjore të fushës së studimeve të kryera. <i>Ref. Nr.19, Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit-Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit e orienton studentin drejt një profesioni të rregulluar, konkretisht sipas VKM-së Nr. 759, datë 12.11.2014 dhe VKM-se Nr. 943 datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, date 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit. <i>Ref. Nr.19, Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit-Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se Departamenti “Inxhinierisë dhe i Arkitekturës” është i angazhuar për t’iu përgjigjur kërkesave në rritje për analiza e kërkime shkencore, që lidhen me forma të reja të mesimnxënies; Programi i studimeve Master i Shkencave siguron përgatitjen e studentëve si ekspertë e kërkues të fushës; por dhe si drejtues kreativ/dizajner në entitete shtetërore e private në saj të njohurive të përftuara, aftësive dhe kompetencave të studentëve. Trajnimet në fushat e “Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, “Agjensinë për eficientësinë e energjisë”, “Agjensinë Shtetërore të Kadastrës atë të Trajtimit të Pronave” si dhe institucione të tjera publike ose private, forcojnë besimin edhe në ushtrimin e profesionistit të lirë.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies gjatë procesit mësimorë në programin e studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi” me profile, janë leksionet, seminarët, punët e laboratorit, detyra praktike dhe/ose detyra kursi, praktika profesionale dhe punimi i diplomës. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, gjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Në bashkëpunim me aktorë të tregut të punës, Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës në mënyrë të rregullt organizon mbajtjen e leksioneve të hapura duke ftuar ekspertë të spikatur në fushën e projektimit dhe zbatimit të veprave të ndërtimit me shkallë vështirësie të lartë.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Programi i përfshin forma të ndryshme të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe kontrollit të dijeve të fituara; të cilat janë në përputhje edhe me përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve si dhe fushën apo natyrën e programit të studimit në inxhinieri ndërtimi. UET, në kuadër të Strategjisë Kornizë, 2018-2022 ka investuar për të siguruar një mjedis cilësor në mësimdhënie dhe mësimnxënie, nga viti akademik 2023-2024, Universiteti ka miratuar "Politikën e të nxënit, mësimdhënies dhe vlerësimit me në qendër studentin". Sipas fushës së studimit dhe feedback-ut të studentëve, stafi akademik mësimdhënës veç formave klasike, përdor dhe metoda formate të tjera të mësimdhënies e mësimnxënies, si p.sh. referimet me gojë të studentëve, detyra të

	<p>shkruara me shkrim (ese), projekte studimi në grup, mjete audio-vizive, leksione të hapura me specialistë të fushës, vizita dhe eskursionë mësimore e studimore në objekte dhe vepra ndërtimore etj. Ndërthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe atyre specifike, përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre ka mundësuar realizimin me sukses të të gjitha veprimtarive të programuara në mësimdhënie. Studentëve, iu janë krijuar kushte dhe mundësi që të shfrytëzojnë aftësitë e tyre kompjuterike, për të patur akses edhe në dokumente të tjera në shkollë.</p> <p><i>Ref. Nr. 3.6, Vendimi nr 9, datë 06.07.2023 Për miratimin e dokumentit SCL Teaching and Assessment Policy.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nje drejtim i rendesishem per sigurimin e brendshem te cilesise ne UET lidhet me trajnimin e pedagoqeve. Institucioni siguron nje program trajnimi te strukturuar per stafin akademik ne perputhje me graden shkencore. Strategjia e përmirësimit të metodave në mësimdhënie e mësimnxënie dhe inkurajimi i fakultetit është objektiv kryesor në këtë Universitet. Në UET organizohen periodikisht “Staff Development Day”, Dita e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien e mësimnxënien, kërkimin shkencorë dhe projektet. Kështu, në muajin Tetor 2023 UET ka zhvilluar trajnime me stafin e brendshëm akademik Msc dhe Dr, të cilët i janë nënshtruar testimit me datë 15 maj 2024. Gjithashtu, stafi akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike përfiton edhe në kuadër të shkëmbimeve të programit ERASMUS+.</p> <p><i>Ref. Nr. 28 - 28.4, Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p>	<p>Për vlerësimin e njohurive dhe metodave të mësimdhënies, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përzgjidhet nëpërmjet një procesi serioz. Në programin Master i Shkencave në Inxhinieri Ndertimi me dy profile; “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti”, GVJ, vlerëson personelin akademik me tituj e grada shkencore dhe background-in e tyre profesional në këtë fushë studimi. GVJ, gjatë takimit në Institucion me stafin, konstatoi nga afër kompetencën e tyre edhe në ndarjen e lëndëve sipas fushës së kualifikimit. Mësimdhënia e stafit akademik në lëndët e këtij programi studimi, përfshin veç metodave</p>



<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>tradicionale edhe metoda interaktive duke përfshirë edhe studentët në diskutime gjatë orëve të mësimi.</p> <p><i>Ref. Nr.19, Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit - Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës është njësia bazë për përgjegjëse për programin e studimit dhe sigurimin e cilësisë. Përfshirja e studentëve dhe mendimet e tyre për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies nga personeli akademik dhe vlerësimi të të nxënit dhe cilësisë janë në qendër të vëmendjes të UET. Drejtuesi i fakultetit dhe përgjegjësi i departamentit kryejn verifikimet e shqetësimeve të ngritura nga studentët, dhe pasi kryejn verifikimet e nevojshme, marrin vendime për përmirësim të cilësisë së standardeve. Masat mund të jenë ndryshime në programe të lëndëve, ndryshime në curricula e lëndëve ose në rastet kur vlerësohet moskompetencë e aftësive të pedagogut edhe më ndryshime të personelit akademik. Nëqoftëse shqetësimet lidhen me ndryshime të rregullores së UET atëhere ato trajtohen në mbledhje të Rektoratit.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimi të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Struktura që punon për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi është Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe sektorët në varësi të tij si Zyra e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC), Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimit dhe Vlerësimi të Performancës Akademike, etj. vlerësojnë në mënyrë periodike veprimtarinë mësimore e kërkimore shkencore si dhe bëjnë propozime për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit në Universitetin UET. Në lidhje me zhvillimin e metodave të reja inovative mësimore, Universiteti UET ofron trajnime vjetore për stafin ekzistues dhe atë të ri. Për këtë qëllim, njësitë paraqesin në Rektorat planet e aktiviteteve të tyre me propozime konkrete para fillimit të vitit të ri akademik. Këto aktivitete në planin e tyre parashikojnë nevojat për staf të ri akademik dhe aktivitetet të të nxënit sipas përparësive në përputhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit të UET.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Institucioni ka ndërmarrë masa të</i></p>

	<p><i>përshtatshme dhe të qëndrueshme për të garantuar cilësinë e procesit mësimor, në përputhje me kërkesat e standardit. Metodatat e përdorura janë të larmishme dhe të përshtatura me natyrën e programit, përfshirja e studentëve është e dukshme, dhe vlerësimi i vazhdueshëm i stafit dhe i rezultateve të të nxëniet mbështetet në struktura funksionale për sigurimin e cilësisë. Po ashtu, angazhimi në trajnime dhe bashkëpunime ndërkombëtare dëshmon orientimin e institucionit drejt përmirësimit të vazhdueshëm.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive, të përcaktuara në Rregulloren e Programit të studimit pika 5 “Kontrolli dhe vlerësim i dijeve” si dhe në dokumente të veçanta si Broshura e Dokumenteve “Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive”, të cilat u bëhen me dije studentëve të rinj gjatë javës së orientimit por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Kriteret dhe mënyra e testimit apo vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive janë publike dhe ofrohen edhe nga Koordinatorë e Departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Të gjitha këto elementë janë të publikuara edhe në WEB-site i Universitetit UET.</p> <p><i>Ref. Nr7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Në fillimi të çdo lënde studentët njihen me metodat e testimit dhe vlerësimin e tyre. Detaje dhe informacione për programin e studimit në Inxhinieri Ndërtimi gjenden në forma të ndryshme; të shkruara dhe elektronike. Programet e lëndëve janë të publikuara në faqen kryesore të Universitetit UET siç janë: Prezantimi i programit të lëndës nga çdo pedagog në orën e parë të mësimin.</p>

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Është përgjegjësi e stafit akademik t'i njohë studentët gjatë javës së parë të semestrit me programin e plotë të lëndës; ku studentët njihen edhe me objektivat e lëndës, tematikat, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar, metodat e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Nga ana e tyre studentët mund të njihen për këto informacione edhe në faqen e internetit në platformën LMS dhe programet lëndore. Vlerësimi me shkrim ose/dhe me gojë bëhet me pikë nga 0-100; rezultati përfundimtar konvertohet me notën 4 (katër) deri 10 (dhjetë), ku notat nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) janë kaluese.</p> <p><i>Ref. Nr. 7.2, Sistemi i vlerësimit të studentëve</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve është i shprehur në programet lëndore për çdo lëndë. GVJ, vlerëson metodat që përdoren për kontrollin e njohurive dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren mbi vlerësimin e studentëve duke u dhënë mundësi studentëve të tregojnë kompetencat dhe njohuritë e fituara bëhet nëpërmjet një vlerësimi të trefishtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nxitja e studentëve që të mësojnë gjatë gjithë periudhës së vitit akademik; siguron një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponente në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në provim; - Shërben si vlerësim në ecurinë e kursit gjatë gjithë semestrit, të ofruar në leksione/seminare etj. - Format e vlerësimit janë të larmishme në varësi të lëndëve dhe zgjedhjeve që bën pedagogu në Detyra, Prezantime, Projekte, Laboratore/dhe testime laboratorike, seminare etj. <p><i>Vizita në UET, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se metodat e vlerësimit të njohurive dhe dijeve e kompetencave janë përcaktuar të plota në rregulloren e programit të studimit, ato janë publike dhe njihen nga studentët. Këto u bëhen të njohura studentëve në fillim të çdo viti të ri akademik për çdo lëndë/modul.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ, referuar burimeve alternative, syllabuseve, rregulloreve e stafit akademik lu n joh edhe me vlerësimin e elementeve kryesore të kontrollit të vazhdueshëm siç janë: provimet, punimet/projektet dhe niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, provime të ndërmjetme, vlerësime në bazë të pyetje/përgjigjeve, etj. Periudhat e provimeve për këtë program studimi janë: Provimi i ndërmjetmë, java e 7 semstrit dhe Provimi final, javët 15 dhe 16 të semestrit. Ndërmjet këtyre periudhave studentëve u kërkohet të punojnë në studime, hartimin e projekteve, të bëjnë prezantime etj. GVJ mendon se fusha e vlerësimit të studentëve është e gjerë dhe e shpërndarë gjatë gjithë periudhës së semestrit duke i dhënë rëndësi Provimit të ndërmjetëm (java e 7-të e semestrit) ndërsa Provimit përfundimtar (në javët 15 e 16); Riprovimeve dhe Mbrojtjes së tezës së diplomës. Si rregull, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit deri sa fleta e korigjuar dorëzohet në Sekretari Mësimore. Nota përfundimtare përfshin vlerësimin e të gjitha komponentëve të përmendur më lart duke marrë në konsideratë frekuentimin dhe aktivizimin gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p><i>Ref. Nr 5, Rregullore e UET, Neni 27, faqe 8; Ref. Nr. 5, Rregullore e UET, Neni 27, pika 27.4, faqe 8; Ref. Nr.19, Formatit i Syllabusit shqip anglisht, VKM 41/2018.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Universiteti UET përdor sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit në rastet kaur ka qenë e aplikueshme, dmth sipas karakterit të lëndës sbëhen edhe vlerësimet e studentëve. UET në bashkëpunim me AADF në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) ka filluar promovimin e një sistemi të ri vlerësimi elektronik "clean scoring". Ky sistem është aplikuar për lëndë të ndryshme në nivelet "Bachelor" dhe "Master; GVJ, mendon se nëpërmjet këtij vlerësimi sistemet e testimit e vlerësimit të studentëve janë transparente, me fokus eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion si dhe Rregullores së Programit të Studimit Master Profesional në</p>

<p>përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>“Inxhinieri Ndërtimi” me profile, “Mbi Programet e Studimit të Ciklit të dytë”, neni 37, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje të plotë me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Studentët informohen paraprakisht për kriteret e dhe procedurat e vlerësimit. Sipas natyrës së lëndëve, aplikohet ndarja në Tipologji I (lëndë me përmbajtje njohurish kryesisht aplikative) dhe Tipologji II (lëndë me përmbajtje të madhe teorike). Për lëndët e tipologjisë I, aplikohet vlerësimi i ndarë në komponente si detyra praktike nr. 1 - 30%; detyra praktike nr.2 - 30%; provimi final - 40%. Për lëndët e tipologjisë II, aplikohet vlerësimi i ndarë në këto komponente: aktivizimi në seminare - I 0%; detyra e kursit - 20% ; provimi i ndërmjetëm - 30% dhe provimi final - 40%. Për praktikat profesionale dhe punimin e diplomës/provimi i përgjithshëm vlerësimi është detyrimisht në komision. Në rast se studenti ka ankesë për komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtroje arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtare, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Provimet sekretohen, sallat e provimeve monitorohen me personel të përzgjedhur monitorues. Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehte emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore; në këto raste provimi monitorohet nga dy pedagogë, që miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p><i>Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, pika 5.2 dhe 5.3.3; Ref. Nr. 5, Rregullore e UET, neni 27, pika 4; Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, pika 5.8; Ref. Nr. 7, Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, pika 5.3; Ref. Nr. 9, Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mesimore, pika E.1.8.6; Ref. Nr.7.2, Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6.e.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me</p>	<p>Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>

<p>komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>shoqërohet me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen. Në fund të pyetjeve, është një seksion i emërtuar "Vlerësimi i pedagogut", ku pedagogu jep feedback mbi esenë e studentit me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Në tezat e provimeve është seksioni "Komente të pedagogut" për përgjigjet e studentit për pyetjen e kategorise C "Mbah qëndrimin tënd", kategori e cila përfshin skicë-ide të shpejta për të kontrolluar aftësitë e studentit; ku pedagogu bën vlerësimin me përshkrim/feedback të përgjigjeve të pyetjeve nga studentit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ. pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në RVB periodik si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se Universiteti ndjek politika lidhur për kopjimin, plagjiaturën dhe çdo element tjetër që shtrembëron vlerësimin e studentit duke u bazuar në Rregulloren e Institucionale. Prej vitit 2015 UET aplikon programin Turnitin, për të verifikuar plagjiaturën për detyrat e shkruara, detyrat javore dhe teza e diplomave përpara se të marrin vlerësimin final nga ana e pedagogëve apo e komisioneve të vlerësimeve përkatëse.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritën e studentëve. Të gjitha provimet zhvillohen në anonimata të plotë po ashtu edhe vlerësimi i studentit bëhet me pikë për secilën pyetje dhe me pas mblidhen. Fleta e provimit firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën edhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i rezultateve të provimeve duhet të bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre ndërsa në rastin e riprovimeve, ku numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë. Vlerësimi për komponentet e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, në këto raste pedagogut nuk i lejohet të ndërhyjë për ndryshime pas dhënies së rezultateve të provimeve.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Universiteti UET garanton të drejtën e studentëve për informim për vlerësimin njëherazi edhe për të kërkuar rishikim të vlerësimit. Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (LMS dhe UMIS). Brenda dy javëve pas publikimit të rezultateve të provimit, në një orë të caktuar për tutoriat dhe/ose keshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim që ata kanë lidhur me</p>

	<p>vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Ref. Nr. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtën të bëjë ankesë për ankimim të vlerësimit në sekretarinë e Mësimore, duke kërkuar rishikim të provimit. Një komision vlerësimi ngrihet në department për të shqyrtuar ankimet e studentëve, ku janë të përfshira pedagogë kompetentë për të gjykuar problematikën e ngritur nga studenti në mënyrë transparente. E gjithë procedura e zbatuar dokumentohet dhe arkivohet. Nëqoftëse studenti nuk është i bindur atëherë Ai mund t'i drejtohet Departamentit për rivlerësim; në këto raste vlerësimi I komisionit është përfundimtar, pavarësisht nga vlerësimi i kontestuar. E gjithë procedura e zbatuar dokumentohet dhe arkivohet. Sekretaria mësimore ngarkohet për të ndjekur dokumentacionin.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik, që në fund pasqyrohet me vlerësimin final. Në provime ruhet anonimati i studentëve nëpërmjet kodit unik elektronik (EIS) dhe programit Turnitin, duke shmangur kopjimin dhe plagjaturën në të gjitha punimet e shkruara. Rishikimi i vlerësimit të provimeve është një e drejtë e studentëve që vlerësohet nga Komisioni i vlerësimeve sa herë studenti aplikon për rishikim të vlerësimit. Të gjitha dokumentacionet arkivohen.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ASCAL si dhe gjatë vizitës në Institucion vlerëson kurrikulën e programit të studimit në Master i Shkencave “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile “Infrastrukturë Transporti”, “Inxhinieri Strukturash”, e cila përmban module dhe lëndë sipas udhëzimit 41, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe</p>

	<p>shkencore të studentëve në funksion të menaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit. Në program përfshihen një paketë e lëndëve bazë për dy profilet Inxhinieri Struktura dhe Infrastrukturë Transporti, pastaj studentët për të kaluar në profilin e studimeve që dëshirojnë duhet të bëjnë zgjedhje edhe për dy lëndë. Në këtë mënyrë, është zgjidhur edhe një rekomandim i GVJ në akredimin e parë. Lëndët që trajtohen në dy profilet përfshijnë sa vijon: Teori e avancuar e strukturave, Mekanika e dherave, Konstruksione Speciale Beton- Arme, Ura dhe Tunele, Restaurimi dhe Përforcimi i strukturave, Dinamika e strukturave dhe inxhinieria sizmike, Gjeologji e Aplikuar, Strukturat e betonit të armuar, GIS etj. Këto lëndë, së bashku në programin e studimit me dy profile zhvillojnë aftësitë e përgjithshme profesionale dhe ato të veçanta të studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p><i>Ref. Nr. 14, Kurrikula e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi. (Tabela 12.3)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në zbatim të VKM 41, datë 24.1.2018, GVJ vlerëson ndarjen e lëndëve në module; në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Çdo lëndë ka një nivel të caktuar që mundëson arritjen e objektivat e programit të studimit. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e dy profileve të zgjedhura nga studentët; ndërsa fusha e komunikimit dhe ndërveprimit janë të përfshira në lëndë të programit, që janë të mjaftueshme për nivelin e përgatitjes së studentëve në aplikimet llogaritëse në Inxhinieri Ndërtimi (Kategoria C dhe CE) dhe praktika Profesionale (Kategoria D). Nëpërmjet lëndëve që zhvillohen ndërthuret mjaft mirë leximi, shkrimi dhe komunikimi me aftësitë kërkimore dhe aplikimin e mjeteve IT.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre,</p>	<p>Referuar Kurrikulës së programit të studimit Master I Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi si dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se studenti nëpërmjet lëndëve që zhvillon programi i studimit, objektivave të tyre fiton aftësitë, njohuritë dhe kompetencat për të kryer e zbatuar detyra specifike. Si rregull, në javën e fundit të përfundimit të lëndës, pedagogët zhvillojnë përsëritje të koncepteve bazë të zhvilluara duke shkëmbyer mendime për njohuritë e fituara dhe se çfarë duhej të bëhëj më mirë për të përmirësuar. Gjatë prezantimit detyrave të kursit/projekteve në orët e seminareve studentëve u jepet mundësia e paraqitjes së tyre</p>

<p>si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>në grup prej 2-3 vetë, sipas tematikave të përzgjedhura; nëpërmjet të cilave ata zhvillojnë edhe aftësitë e tyre për të punuar në grup.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ, vlerëson përbajtjen e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet, që ndihmojnë për t'i pajisë studentët me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, u japin mundësi studentëve për të zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë. Institucioni dhe Personeli akademik kanë krijuar klimën dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e ideve inovative, për studime e kërkime shkencore; pjesëmarrje në Konferenca Studentore. Personeli akademik nxit bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe punën e tyre në grup. Në orët e siminareve pedagogët trajtojnë raste të ndryshme studimore sipas natyrës së lëndëve të ndryshme të përcaktuara më parë; për interpretimin dhe zgjidhjen e të cilave angazhon studentë në grupe pune prej 2 dhe 3 vetë, ku ata shpalosin ideve inovative e teknologjike në dobi të institucionit, shoqërisë ose palëve të treta.</p> <p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe gjatë takimeve në Institucion vlerëson nënshkrimin e 25 marrëveshjeve për bashkëpunime, një mundësi për mobilitete të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhiniri Ndërtimi" me dy profile.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i departamentit jashtë programit mësimor është i përfshirë në aktivitete e veprimtari shkencore, për të qëndruar sa më afër bashkëpunimit me industrinë e ndërtimit në kuadër të këtij programi studimi. UET zhvillon rregullisht leksione të hapura, nga pedagogë të tij ose ekspertë të ftuar, për problematika aktuale dhe zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë në fushën e ndërtimit. Leksione zhvillohen si në kuadër të lëndëve të programit mësimorë, ashtu edhe si aktivitete jashtëkurrikulave, ato janë të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik.</p> <p><i>Ref. Nr. 55.1, Kalendari i aktiviteteve 2023-2024; Ref. Nr. 55.2, Kalendari i aktiviteteve 2024-2025; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara</p>	<p>UET nxit zhvillimin e ideve inovative për kërkime shkencore të studentëve duke i mbështetur ato edhe finaciarisht. Sipas "Strategjisë Kërkimore Shkencore"; Vizioni, pika 1.2, Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së</p>

kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkohore në fushën e shkencës tek studentet si dhe përfshijes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>		
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" ofron aftësitë e nevojshme në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, komunikimit ndërveprimit në gjuhën shqipe. Universiteti UET nxit idetë novative në kërkime shkencore dhe jep mbështetje financiare.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	GVJ, vlerëson hartimin nga institucioni të një procedurë të veçantë, për studentët që mbrojnë diplomën; duke hartuar kriterë specifikë për detyrimet përmbyllëse edhe për programet e Ciklit të Dytë të Studimeve në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy profile "Inxhinieri Struktura" dhe "Infrastrukturë Transporti" (Dokumenti 8.11). Procesi i diplomimit të studentëve në universitetin UET është trajtuar në detaje nëpërmjet akteve të brendshme të përgatitura nga "Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës". Në Rregulloren e punimit të diplomës, janë të përshkruara procedurat që duhet të ndjekin studentët, nga aplikimi për temën e diplomës, zgjedhjen dhe miratimin e udhëheqësit, kontrollet e detyrueshme, formati i dorëzimit dhe mbrojtjen e diplomës përpara komisionit. <i>Ref. Nr.5, Rregullore UET, neni 39; Ref.Nr.10, Dokumenti 8.11, "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit"; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës.

<p>duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës gjate seancave metodologjike asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, i orienton studentët për literaturën që duhet të konsultojnë në funksion të projektit, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit dhe në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me 2 profile nuk përfshin provim të përgjithshëm si detyrim përmbyllës. Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore Studentët e këtij programi studimi vlerësohen nëpërmjet lëndëve që përmban kurrikula e programit dhe mbrojtja e tezës së diplomës.</p> <p><i>Ref.Nr.10, Dokumenti "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit" pika B.II.5.2 dhe B.II.8.8; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Gjatë semestrit të dytë të studimeve, studentët përzgjedhin si lëndë kryesore "Projekti final" që ka të bëjë me punimin e temës së diplomës. Për udhëheqjen e temës së diplomës, për çdo student caktohet një pedagog, i cili njëkohësisht krijon kushte e mundësi që studentit të punojë në mënyrë të pavarur. Pedagogu udhëheqës konsulton studentin në etapat e realizimit të diplomës deri në variantin final. Në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës hartojnë programin e temës së diplomës, ku janë të përfshira dhe konsultimet. Udhëheqësi i temës së diplomës garanton cilësinë e rezultateve të arritura, do të asistojë dhe udhëzojë studentin gjatë gjithë periudhës deri në miratimin ose jo në dorëzimin e variantit final.</p> <p><i>Ref. Nr. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB); Ref. Nr., Programet lëndore që përmban kurrikula e programit të studimit Master professional në Inxhinieri Ndërtimi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët e Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit në plotësim të objektivave të programit të studimit, sipas temave dhe fushës së studimit kanë në dispozicion të tyre laboratorin e Universitetit UET, për kryerjen e testeve të materialeve të ndërtimit (betone, çelike, çimento etj.) si dhe atë të matjeve dhe regjistrimit të të dhënave për efikasitetin e energjisë në ndërtesa, me vendndodhje pranë Forndit Shqiptar të Zhvillimit, në Tiranë. GVJ, vlerëson punën e institucionit për ndihmën që u ofron studentëve me pyetsorët e tyre tek studentët nëpërmjet koordinatorit të programit</p>

	të studimit dhe ndihmës për kërkesat që ata kanë, në proçin e mbledhjes së të dhënave jashtë institucionit.			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas Rregullore “Për provimet e Studimeve të Ciklit të Dytë”, pika B.II.5.2 dhe B.II.8.8, Mbrojtja e punimit të Diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e notave të antarëve të komisionit të vlerësimit. Ky vlerësim bashkë me Proces-Verbalin bëhet publik në prani të studentëve të diplomantë në fund të seancës të mbrojtjes së diplomave.			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar dokumentacionit të aksesuar (Neni 40 i Rregullores së UET) si dhe takimeve të zhvilluara në institucion GVJ , vlerëson se programi Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me 2 profile, ka të miratuara procedurat për diplomim dhe pajisjen brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën, të shoqëruar me certifikatën e notave të studimeve universitare në UET dhe me suplementin e diplomës (në gjuhët shqip dhe anglisht); të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm, në përputhje edhe me Urdhërin nr. 78 datë 13.05.2020, Prot.1434/6 të MAS/QSHA. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Universiteti UET, ruan të arkivuar për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit për çdo student që ka kryer studimet dhe rast pas rasti paraqet, informacione për studentin për gjithë periudhën e studimeve nëqoftëse do të kërkohen (Data base e plotë e të dhënave statistikore për studentë) sipas kërkesave të ministrisë së linjës, Agjensisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe nevojave të vetë institucionit.			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Personeli akademik/ udhëheqësi i diplomës orienton studentët në përmbushjen e programit të diplomës me nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, shkrimin përfundimtar sipa udhëzimeve përkatëse. Në fund të punimit dhe mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset zyrtarisht me diplomën dhe suplementin e saj, formatet e të cilave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit Rinisë e Sporteve. I gjithë dokumentacioni i studentit (kopje) arshivohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se dokumentacioni kërkohet nga studentit për arsye të caktuara, i jepet atij pa asnjë pengesë.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter i standardit nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter i standardit nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter i standardit nuk aplikohet për këtë program studimi.

Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Gjatë vizitës në institucion Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin: diplomat, certifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetsore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj. Kjo gjë u konstatua gjatë shqyrtimit të disa dosjeve, të cilat u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme nga GVJ. Në bazë të Statutit, të dhënat e stafit efektiv dhe me atij me kontratë administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional dhe nga njësia kryesore dhe njësitë bazë për program studimi. I gjithë informacioni administrohet duke respektuar

konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohen konform akteve rregullatore institucionale

Për tre vite akademike të dhënat e stafit për program studimi vijnë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	1
Prof.As.Dr	1	-	1	1	1	-
Dr	4	2	5	1	5	1
MSc				1	2	1
Total	5	2	6	3	8	3

Ref. 2. Statuti UET

Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore

Ref. 16. A.II. Kodi i Etikës

Vizita në Institucion

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Bazuar në Rregulloren për burimet njerëzore, Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinieris së Ndërtimitë ka në përgjegjesinë e tij edhe pjesën e përpunimit të të dhënave dhe parashikimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv dhe me kontratë që do të angazhohet në këtë program studimi në fillim të secilit vit akademik. Në përfundim të vitit akademik, administrohet edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore [Ref. 11, Ref. 25].

Bazuar në informacionin e dhënë në dokumentacion, si edhe intervistat e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të konkludojmë se stafi i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar nga ana e gradave shkencore. Fusha e kualifikimit është në përputhje me angazhimin e secilit anëtar me mbulimin e lëndëve dhe specikat e tyre. Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Referuar tabelës përmbledhëse (tabela nr.12., 12.2, 12.3), GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit. Për

	tre vite akademike, mbulimi i ngarkeses mësimore nga stafi akademik të programit të studimit të studimit vijojnë si më poshtë:							
	Mbulimi i ngarkeses mësimore nga stafi akademik të programit të studimit		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
			PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Në orë	568	284	733.5	264.5	944	178	
	Në %	67%	33%	73%	27%	84%	14%	
	<p><i>Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>Ref. 25. Tabelat permbledhese</i></p>							
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<p>Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet përmes kontratës individuale të punës që nënshkruhet me secilin prej tyre. Kontratat hartohen në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshijnë të gjitha elementet e nevojshëm për të siguruar dhe demonstruar vullnetin e universitetit për qëndrueshmërinë e stafit akademik, duke përfshirë kontributet shoqërore dhe shëndetësore siç janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të shihte dosjet fizike të personelit të angazhuar dhe ishin korrekte me dokumentacion të plotë.</p> <p><i>Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore; Vizita në Institucion</i></p>							
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	<p>Institucioni, duke u bazuar në Statut dhe në Rregulloren për Burimet Njerëzore, harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik. Përzgjedhja bazohet në kritere të publikuara nga njesia bazë për kualifikimin akademik, përputhjen me lëndët/modulet dhe përvojën e nevojshme. Shpalljet për personel shfaqen në faqet eeb të institucionit. Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatave kryhet përmes komisionit të rekrutimit në përputhje me përcaktimet e Statutit dhe me procedurat e punësimit në UET. Punësimi i personelit në institucion përmbillet me lidhjen e kontratës nëpërmjet Rektorit të UET si punëdhënës dhe kandidatit fitues si punëmarrës. GVJ nga</p>							

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dokumentacionet e shqyrtuara dhe vizita në institucion konstaton se procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p><i>Ref. 2. Statuti UET</i> <i>Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>Ref. 16. Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton angazhimin e një personeli ndihmës akademik në mbështetje të programit mësimor. Kryesisht personeli ndihmes akademik është i përfshirë në laboratorë, në dhënien e asistencës së personelit akademik gjatë procesit mësimor dhe mbikqyrjen e studentëve gjatë orëve laboratorike.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore e UET është strukturë përgjegjëse për administrimin e të dhënave të personelit akademik. Kjo zyrë mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat në përputhje me legjislacionin në fuqi</p> <p><i>Ref. 11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>Ref. 24. Tabelat përmbledhese</i> <i>Ref. 44.1. Format dosje staf akademik me kohë të plotë</i> <i>Ref. 44.2. Format dosje staf akademik me kohë të pjesëshme</i> <i>Vizita në Institucion: takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>Institucioni bashkëpunon me një rrjet aktorësh të jashtëm për realizimin e praktikave profesionale, duke përfshirë institucione publike dhe kompani private, me të cilat janë firmosur memorandume bashkëpunimi. DVV dëshmon se komunikimi me këto institucione është i vazhdueshëm, dhe objektivi është garantimi i mundësive të praktikës dhe mbështetjes së studentëve gjatë saj.</p>

<p>udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Departamentet zgjedhin ekspertë të fushës për të mbuluar seancat e programit të praktikës. Pedagogu përgjegjës për këtë PS gjatë 2024-2025, i cili mbikëqyrin zbatimin e planit të praktikës sipas moduleve dhe fushës së studimit, është Gazmir Hallaci. Përcaktohet gjithashtu pedagogu këshillues i karrierës, që ndihmon në aspektet procedurale dhe ndjek dokumentacionin e nevojshëm për çdo student.</p> <p><i>Ref. 32.1. Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale</i> <i>Ref. 34. Marreveshje bashkepunimi - Lista UET</i> <i>Ref. 24. Tabelat permbledhese</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga analiza e DVV rezulton se personeli mbikëqyrës në ambientin pritës është përfshirë aktivisht në të gjitha fazat e praktikës profesionale: nga nënshkrimi i marrëveshjes, udhëzimi gjatë periudhës së praktikës, deri tek vlerësimi i performancës së studentit. Vlerësimi përfundimtar mbështetet në raportet e praktikës, të dorëzuara nga vetë studentët, të mbështetura me nënshkrime nga mbikëqyrësit e jashtëm dhe nga pedagogu udhëheqës.</p> <p>Specifikisht për programin e Masterit Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi, me profile, përcaktohet detyrimi për realizimin e 300 orëve pune praktike për student, prej të cilave 8 orë zhvillohen në auditor dhe pjesa tjetër në ambiente profesionale. Kjo praktike shpërmdahet në 2 semestra, në Vitin e parë. Nga vizita në Institucion dhe takimet e kryera, GVJ konstatoi se studentët në semestrin e parë realizonin 8 orë në auditor dhe vizita në kompani të ndryshme, dhe në semestrin e dytë angazhohen në punën praktike në industri.</p> <p><i>Ref. 32.2. B-I-4 Formulari i vetvlerësimit të praktikës (nga Studenti)</i> <i>Ref. 32.1. Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ përveç shqyrtimit të dokumentacionit, gjatë vizitës dhe intervistave konstatoi se institucioni realizon një proces korrekt të rekrutimit të personelit akademik, mban një dokumentacion fizik sipas dispozitave liigjore në fuqi për çdo anëtar të personelit akademik të angazhuar në program. Informacioni profesional për stafin përditesohet çdo fillim viti si në format fizik ashtu edhe elektronikisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash" e zhvillon procesin mësimor në kampusin universitar në Rrugën "Xhanfize Keko", në ambiente që përfshijnë salla leksionesh dhe seminare, laboratorë, biblioteka, zyra dhe mjedise shërbimi. Raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), si dhe Ref. Nr. 42 – Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, tregojnë për 18 salla seminari me kapacitet 493 vende, 14 salla leksionesh me 1068 vende dhe mjedise të tjera me një sipërfaqe totale të mjaftueshme.</p> <p>Gjithashtu, gjatë takimit me stafin akademik të programit dhe takimit me studentët, GVJ nuk konstatoi ndonjë ankesë apo pakënaqësi në lidhje me mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p><i>Ref. 0.RVB- shqip</i> <i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vëzhgimi i mjediseve në UET gjatë vizitës, si dhe gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit (PS), GVJ konstatoi që sallat që përdoren gjatë procesit mësimor janë të pajisura me pajisje audio-vizuale, PC, projektorë dhe akses internet. UET përdor sistemin LMS për administrimin e mësimin dhe lehtësimin e procesit mësimor në distancë përmes Microsoft Teams. Përdorimi i platformave interaktive dhe mundësitë teknologjike janë në funksion të zhvillimit bashkëkohor të mësimdhënies.</p> <p><i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"</i> <i>Vizita ne Institucion</i></p>

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se mjediset laboratorike janë të pajisura me kompjuterë dhe programe përkatëse në përputhje me fushat e studimit. Universiteti Europian i Tiranës (UET) disponon laboratorë të informatikës, laboratorë inovacioni (InnoLab), si dhe laboratorë VR-AR për simulime virtuale. Pajisjet dhe softuerët e instaluar përfshijnë platforma si: Microsoft Teams, Microsoft SQL Server, Visual Studio Code, MATLAB, AutoCAD, si dhe Moodle (UET LMS), të cilat mbulojnë kërkesat specifike të moduleve mësimore.</p> <p>Nga muaji nëntor 2024, laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është transferuar në një ambient të ri, me vendndodhje: Ish-Instituti i Ndërtimit, Rruga Muhamet Gjollësja, Tiranë. Ky transferim ka sjellë vështirësi në aspektin logjistik për organizimin e seancave laboratorike në funksion të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në ambientet e reja, GVJ konstatoi se laboratori është i pajisur me aparatura dhe instrumente të përshtatshme për realizimin e moduleve praktike.</p> <p><i>Megjithatë, ambienti nuk ishte ende në funksion që prej transferimit. GVJ rekomandon të ndërmerren masa të menjëhershme për funksionalizimin e laboratorit në ambientin e ri. Gjithashtu, rekomandohet të hartohet një planprogram i detajuar i seancave laboratorike, që të adresojë problemet logjistike të shkaktuara nga largësia gjeografike e laboratorit, si dhe të garantohet që studentët të kenë akses të rregullt dhe të organizuar në laborator, në përputhje me kurrikulën dhe objektivat mësimorë.</i></p> <p><i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”; Vizita ne Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe Ref 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, UET zotëron 7 laboratorë të informatikës dhe teknologjisë së informacionit, të cilët janë të pajisur me teknologji të përditësuara për të mbështetur zhvillimin normal të leksioneve dhe seminareve. Laboratori i Inovacionit (InnoLab) dhe projektet si “VR-AR” mundësojnë trajnimin praktik në rrethana të avancuara teknologjike. Në funksion janë gjithashtu laboratorë të pajisur me softuer profesional për programim, modelim, rrjete kompjuterike dhe dizajn.</p> <p><i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”</i></p>



<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike dhe laboratorike nëpërmjet infrastrukturës së vet dhe bashkëpunimit me institucione e kompani të specializuara. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë të dokumentuara dhe në përputhje me kërkesat e programeve të studimit.</p> <p><i>Ref. 32.1. Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale</i> <i>Ref. 33. Të dhëna për trajnimet profesionale</i> <i>Ref. 34. Marrëveshje bashkëpunimi - Lista UET.pdf (34.1- 34.16)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ofron mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profilet "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash". Ambientet në kampusin e UET përfshijnë salla leksionesh, seminare, laboratorë, bibliotekë dhe hapësira mbështetëse, të pajisura me teknologji bashkëkohore, në përputhje me nevojat e programit.</i></p> <p><i>GVJ konfirmoi se laboratorët janë të pajisur me softuerë dhe pajisje përkatëse. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është transferuar në një ambient të ri (Ish-Instituti i Ndërtimit), por ende nuk është funksional, duke sjellë vështirësi logjistike. Rekomandohet të funksionalizohet sa më parë laboratori dhe të hartohet një plan i qartë për seancat laboratorike, duke garantuar akses të rregullt për studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
	✓		X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion, konstatoi që pedagogët e lëndëve prezantojnë çdo fillim semestri tek studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Literatura e rekomanduar është në gjuhën shqipe ose angleze dhe shpërndahet si material shtesë me iniciativë të pedagogëve. Përcjellja e literaturës bazë dhe të rekomanduar tek studentët realizohet në format fizik dhe me raste në format elektronik përmes përmes sistemit LMS të UET. Biblioteka gjithashtu ofron qasje në materiale shtesë</p> <p><i>Ref. 0.RVB- shqip</i> <i>Ref. 45. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga GVB, veçanërisht Syllabuset e lëndëve në PS, GVJ konstaton se literatura e lëndëve është specifikuar në programet mësimore dhe se ajo vihet në dispozicion të departamentit çdo fillim viti akademik për përditësime. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion dhe informacionit të marrë gjatë takimit me stafin akademik te angazhuar ne PS, u konstatua se egziston një procedurë për propozimin dhe blerjen e literaturës së re, përmes plotësimit të formularëve të posaçëm. Literatura përditësohet në bazë të kërkesave të stafit akademik dhe zhvillimeve në fushën përkatëse.</p> <p><i>Ref. 0.RVB- shqip</i> <i>Ref. 45. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit</i> <i>Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në biblioteke</i> <i>Ref. 45.3. Shembull procedure_blerje literature; Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e</p>	<p>Biblioteka e UET është funksionale dhe e pajisur me hapësira leximi, kompjuterë dhe akses online. Studentët e të gjitha programeve kanë mundësi të barabarta përdorimi, pa kufizime sipas fushës së studimit.</p>

shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p><i>Ref. 0.RVB- shqip</i> <i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"; Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UET është funksionale dhe e pajisur me hapësira leximi, kompjuterë dhe akses online. Fondi fizik i bibliotekës në funksion të PS përmban literaturë vendase dhe të huaj: libra, monografi, revista, botime konferencash, etj. Megjithatë, verohet se biblioteka ka një fond të limituar fizik, duke shtruar nevojën për përmirësime dhe shtesa.</p> <p><i>GVJ inkurajon pasurimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të fondit fizik të bibliotekës me literaturë mësimore bazë, të rekomanduar dhe plotësuese, në përputhje me nevojat e studentëve dhe stafit akademik.</i></p> <p><i>Ref. 0.RVB- shqip</i> <i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"; Ref. 45. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC dhe akses Wi-Fi. Studentët mund të përdorin bibliotekën virtuale përmes platformave ndërkombëtare si SAGE dhe EBSCO.</p> <p>Institucioni dhe programet sigurojnë literaturë të përditësuar në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Ref. 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. "Xhanfize Keko"; Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita ne ambientet e bibliotekës, GVJ konstatoi se në hapësirat e bibliotekës janë të vendosura pajisje kompjuterike të lidhura me internet dhe sistemin e bibliotekës online. Pajisjet janë të përshtatshme për kërkime, lexim dhe akses në literaturë elektronike.</p> <p><i>Ref. 0.RVB- shqip; Vizita në ambientet e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në</p>	<p>GVJ konstatoi se Biblioteka e UET-së operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve çdo ditë të javës në orarin 9:00–20:00, duke përfshirë edhe ditën e shtunë (9:00–17:00), për të siguruar që shërbimi të jetë në dispozicion gjatë orareve të tyre të studimit. Orari është i përshtatur me nevojat e studentëve.</p>

<p>përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Ambienti është i qetë dhe i strukturuar për punë individuale dhe studime.</p> <p><i>Ref. 0.RVB- shqip; Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës; Vizita në ambientet e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton që departamenti, në periudhë të vazhdueshme, evidenton nevojat e fondit fizik të bibliotekës dhe ja kalon fakultetit. Ky i fundit ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi.</p> <p>Biblioteka bashkëpunon me njësitë akademike për përditësimin e literaturës dhe raportimin e përdorimit të fondit ekzistues. Theksohet nevoja për të shtuar më tej botime bashkëkohore në fushën e programit, veçanërisht literaturë në gjuhë të huaj dhe shqip në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p><i>Ref. 45. Inventari i teksteve në Bibliotekë për fushën e programit të studimit; Ref. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës; Ref. 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë; Ref. 45.3. Shembull procedure_blerje literature.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se literatura bazë dhe ndihmëse për lëndët e programit të studimit është e specifikuar në syllabuset dhe u vihet në dispozicion studentëve në format fizik dhe elektronik përmes sistemit LMS. Biblioteka është funksionale, me akses të barabartë për të gjithë studentët, pajisje kompjuterike, akses Wi-Fi dhe literaturë online përmes platformave ndërkombëtare si SAGE dhe EBSCO.</i></p> <p><i>Gjithashtu, ekziston një procedurë e rregullt për propozimin dhe përditësimin e literaturës, e cila zbatohet në bashkëpunim me departamentet akademike. Megjithatë, vërehet se fondi fizik i bibliotekës për programin e studimit është i kufizuar, duke shtuar nevojën për pasurim të mëtejshëm, sidomos me literaturë në gjuhë të huaj dhe shqip në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.</i></p>

	<i>Rekomandohet të vijojë pasurimi i fondit fizik të bibliotekës me literaturë bashkëkohore, në përputhje me zhvillimet shkencore dhe nevojat e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>UET disponon sistemin elektronik UMIS, i cili administrohet nga Zyra e Regjistrimeve dhe përfshin të dhënat e studentëve nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Të dhënat ruhen në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe integritetit. Studentët dhe stafi pajisen me kredenciale për përdorim, dhe para diplomimit bëhet verifikimi i të dhënave.</p> <p><i>Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Çdo anëtar i stafit ka akses në databazën "Dokumenta UET" dhe në sistemin UET LMS, ku gjendet informacion mbi programin, oraret, leksionet, provimet, ngarkesën mësimore dhe aktivitetet mësimore. Kjo mbështet ndjekjen dhe monitorimin e detyrave për secilin personel.</p> <p><i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun</i></p>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit ofron akses të organizuar dhe të diferencuar sipas roleve (student, staf akademik, administratë). Personeli akademik ka akses në dokumentacionin dhe informacionet mbi procesin mësimor, ndërsa studentët pajisen me të dhëna mbi ecurinë akademike, përmes UET LMS.</p> <p><i>Ref. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet</i></p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, si dhe pas shqyrtimit të DVV, GVJ konstatoi se Platforma UET LMS është funksionale dhe mbështet komunikimin interaktiv përmes forumeve, njoftimeve, mesazheve dhe dërgimit të materialeve mësimore. Gjithashtu, përdoret platforma Microsoft Teams për leksione dhe aktivitete online. Studentët dhe pedagogët trajnohen për përdorimin e sistemeve përkatëse.</p> <p><i>Vizita në Institucion; Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platforma LMS mundëson ndjekjen në kohë reale të aktivitetit mësimor, përfshirë praninë në leksione, dorëzimin e detyrave, njoftimet, provimet dhe vlerësimet. Gjithashtu, lejon gjenerimin e statistikave për qëllime raportimi nga organet drejtuese.</p> <p><i>Ref. 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS; Ref. 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref. 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref. 46.3. UET LMS Guide per studentet</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare të internetit të UET, publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale paraqesin informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. Faqja zyrtare web jep informacion edhe në gjuhë të huaj, anglisht.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB); www.uet.edu.al</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin përkatës dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se UET disponon një sistem të mirëfunksionuar elektronik të menaxhimit (UMIS dhe LMS), i cili mbulon regjistrimin, ndjekjen dhe diplomimin e studentëve, administrimin e të dhënave të stafit dhe komunikimin ndërmjet palëve. Sistemet ofrojnë akses të personalizuar për studentët dhe stafin akademik, mbështesin mësimdhënien dhe mundësojnë monitorimin në kohë reale të aktiviteteve. Informacionet për programet dhe shërbimet janë të publikuara në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen zyrtare të institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UET harton raporte financiare mujore dhe vjetore në përputhje me buxhetin e miratuar. Shpenzimet prioritizohen sipas nevojave institucionale dhe mekanizmi financiar siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Të ardhurat kryesore vijnë nga tarifat e studentëve dhe projekte të ndryshme. <i>Ref. 49. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1);</i> <i>Ref. 50. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani financiar përfshin të gjitha kategoritë e shpenzimeve si: pagesat për personelin, mirëmbajtjen e mjediseve, pasurimin e literaturës, shërbime IT dhe akses në biblioteka online. Mbështetja financiare është në përputhje me nevojat e programit. <i>Ref. 50.1. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime; Ref. 50.2. Pasqyrat Financiare 2023 me shënime</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe	Institucioni i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm çdo vit. Kontrolli i brendshëm realizohet nga njësi përkatese,

dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	ndërsa ai i jashtëm nga auditues të pavarur. Raportet ofrojnë transparencë mbi pozicionin financiar dhe efektivitetin e menaxhimit. <i>Ref. 50.3. Raport auditimi 2022;_Ref. 50.4. Raport auditimi 2023</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raportet e auditimit përmbajnë analizë të detajuar të realizimit të buxhetit për çdo njësi bazë dhe program studimi. Raportet përmbajnë krahasime me vitin pararendës dhe ofrojnë transparencë mbi ecurinë financiare. <i>Ref. 50.3. Raport auditimi 2022;_Ref. 50.4. Raport auditimi 2023</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Buxheti hartohet çdo vit në muajin tetor, në përputhje me udhëzimet e administratorit dhe miratimin e aksionerëve. Në rast të identifikimit të nevojave të papritura, UET parashikon ndërhyrje për të siguruar vazhdimësinë financiare të programeve. <i>Ref. 50.1. Pasqyrat Financiare 2022 me shënime; Ref. 50.2. Pasqyrat Financiare 2023 me shënime; Ref. 50.3. Raport auditimi 2022;_Ref. 50.4. Raport auditimi 2023</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin financiar dhe raportet e auditimit, GVJ konstaton se UET garanton një sistem të qëndrueshëm planifikimi dhe menaxhimi financiar. Raportet mujore dhe vjetore financiare hartohen në përputhje me buxhetin e miratuar, duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve të nevojshme për mësimdhënie, kërkim, teknologji, literaturë dhe mbështetje për studentët. Institucioni auditohet rregullisht, nga struktura të brendshme dhe të jashtme, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në përdorimin e fondeve. Në rast nevoje, ndërmerren masa për të ruajtur vazhdimësinë financiare të programeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UET-së, si dhe informacionin e faqes zyrtare të internetit të institucionit, GVJ konkludon se procesi i pranimit deri në përfundimin e studimeve është i mbështetur mbi dokumente rregullatore dhe ligjore në fuqi, si dhe mbi strukturat e përcaktuara brenda institucionit për administrimin e ciklit të plotë të studentit. UET zbaton një politikë të qartë në lidhje me përzgjedhjen, transferimin, njohjen e krediteve dhe diplomimin, duke garantuar që çdo fazë e ciklit të jetë e dokumentuar dhe e mbështetur nga udhëzues dhe informacione publike të aksesueshme nga studentët (si p.sh. Guida UET). Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që garantojnë transparencë dhe trajtim të barabartë gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><i>Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref. 5. Rregullore UET; Ref. 7. Rregullore_MSH_Inxhinieri Ndertimi; Ref. 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin; Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Ref. 27.2. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin; Ref. 27.3. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të</p>	<p>GVJ konstaton se politikat dhe procedurat që rregullojnë hyrjen në programet e studimit janë të standardizuara dhe garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët. Kriteret janë publike dhe të</p>

<p>drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>aksesueshme përmes faqes zyrtare të universitetit, ku theksohet se të gjithë kandidatët kanë të drejtën e barazisë në përzgjedhje dhe trajtim gjatë gjithë ciklit të studimeve, pavarësisht gjinisë, etnisë apo aftësive ndryshe.</p> <p><i>Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Ref. 5. Rregullore UET https://uet.edu.al/en/si-te-aplikojme/</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni publikon kriteret e pranimit përpara çdo viti akademik. Pranimi në programin Master të Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile... bëhet sipas kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të institucionit dhe bazuar në kritere specifike të miratuara nga Senati Akademik, të propozuara nga departamenti. Kandidatët regjistrohen në përputhje me kriteret publike dhe dokumentacionin përkatës. UET nuk aplikon kritere shtese për pranimin në PS, përveç atyre të parashikuara me ligj.</p> <p><i>Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Ref. 5. Rregullore UET, neni 42</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se kriteret dhe procedurat e pranimit janë transparente dhe të publikuara përmes faqes zyrtare të institucionit dhe dokumentacionit të shpërndarë gjatë aktiviteteve promovuese me shkollat e mesme. Studentët informohen paraprakisht për kërkesat për përzgjedhje, dokumentacionin dhe afatet për aplikim. Dokumentet janë të aksesueshme online dhe gjatë vizitave të drejtpërdrejta në institucion.</p> <p><i>Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Ref. 5. Rregullore UET; https://uet.edu.al/en/si-te-aplikojme/</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konkludon se, përpara fillimit të çdo viti akademik, UET ndërmerr fushata ndërgjegjëse dhe informuese për të komunikuar dhe promovuar programet e studimit, nëpërmjet faqes zyrtare, rrjeteve sociale, zyrës së pranimeve dhe zyrës së këshillimit të karrierës. Informacioni është i qasshëm për të interesuarit dhe përfshin të gjitha detajet mbi aplikimin dhe kërkesat specifike për çdo program.</p> <p><i>Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e</i></p>

	<i>pranimit të studentëve; Ref. 5. Rregullore UET https://uet.edu.al/en/si-te-aplikojme/</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se Institucioni parashikon kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. UET ka politika gjithëpërfshirëse për të garantuar aksesin dhe mbështetjen e nevojshme për këto kategori, duke ofruar kushte të përshtatura dhe përkrahje përmes strukturave përkatëse. <i>Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Ref. 5. Rregullore UET</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UET parashikon kuota dhe mundësi transferimi për studentët që kanë ndjekur studime në institucione të tjera, publike apo private, brenda ose jashtë vendit. Njohja e krediteve, njësitë ECTS dhe përshtatja e kurrikulës rregullohen sipas akteve normative. <i>Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve; Ref. 5. Rregullore UET; Ref. 7. Rregullore_MSH_Inxhinieri Ndertimi; Ref. 27.2. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UET ofron skema bursash dhe ndihmash për studentë në nevojë apo me aftësi të kufizuara, me qëllim përmirësimin e aksesit dhe rritjen e përfshirjes në arsimin e lartë. Këto mbështetje bazohen në kritere të përcaktuara qartë dhe synojnë të rrisin cilësinë dhe diversitetin në procesin e pranimit. Politikat janë të dokumentuara dhe zbatohen në mënyrë transparente. <i>Ref. 5. Rregullore UET, neni 12; Ref. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se UET zbaton politika dhe procedura të qarta dhe të dokumentuara për pranimin, përzgjedhjen, transferimin, njohjen e krediteve dhe diplomimin. Kriteret janë transparente, të publikuara dhe garantuese të trajtimit të barabartë për të gjithë kandidatët, duke përfshirë edhe kategori të veçanta. Aksesueshmëria e informacionit dhe ndihma për studentët janë të garantuara në çdo fazë të ciklit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, si dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare internet të UET-së, GVJ vlerëson se UET ka të rregulluara qartë procedurat për përparimin akademik përmes rregullores së programit të studimit dhe rregullores së përgjithshme institucionale. Studentët informohen për të drejtat dhe detyrat akademike, zhvillimin e provimeve, dokumentimin e vlerësimeve dhe kriteret për kalimin në vit tjetër përmes Zyrës së Këshillimit, Sekretarisë Mësimore dhe platformës LMS. Kjo strukturë garanton transparencë dhe vazhdimësi në procesin akademik.</p> <p><i>Ref. 7. Rregullore_MSH_Inxhinieri Ndertimi Ref. 5. Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni ka siguruar që procedurat dhe kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të jenë të qarta dhe të komunikohen në mënyrë efektive. GVJ konstaton që UET zbaton një politikë të përcaktuar për njohjen e studimeve të mëparshme dhe kualifikimeve në përputhje me Kartën e Bolonjës. Procesi i transferimeve është transparent dhe i dokumentuar në dokumentin për transferimet dhe mobilitetin (Ref. Nr. 27.2). Studentët që aplikojnë për njohje kreditesh udhëzohen nga Zyrat e Kujdesit ndaj Studentit dhe e drejta e transferimit është e dokumentuar dhe e aksesueshme.</p> <p><i>Ref 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref 27.2. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedurat e vlerësimit janë të qarta dhe të përcaktuara në rregulloren e programit. Studentët informohen që në fillim të vitit akademik për mënyrat e vlerësimit, kriteret dhe peshën e secilit komponent të notimit, ne bazë të klasifikimit të lendes në tipologji 1 dhe tipologji 2. Këto të dhëna përfshihen në syllabuset dhe shpërndahen përmes sistemit LMS, duke siguruar transparencë dhe qartësi të plotë.</p>

	<i>Ref 7. Rregullore MSH_Inxhinieri Ndertimi; Ref. 19.1-19.17. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton që institucioni ka ndërmarrë hapa të qartë për të siguruar që studentët janë të mirë informuar mbi procedurat dhe kriteret që lidhen me përgatitjen e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit.</p> <p>Procesi i punimit të diplomës dhe diplomimit është i strukturuar dhe i shpjeguar në mënyrë të detajuar përmes një dokumenti të dedikuar “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” (Ref. Nr. 10). Studentët informohen për fazat e përzgjedhjes së temës, dorëzimin e projektit dhe mbrojtjen e diplomës. Informacioni jepet në fillim të vitit akademik dhe përditësohet në përputhje me kalendarin akademik.</p> <p><i>Ref 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit; Ref 10.1. Kalendarit akademik 2022-2023; Ref 10.2. Kalendarit akademik 2023-2024; Ref 10.3. Kalendarit akademik 2024-2025</i></p>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>UET ka krijuar një praktikë të konsoliduar të informimit të studentëve përmes organizimit të Javës së Orientimit, e cila zhvillohet çdo fillim viti akademik dhe synon të ndihmojë studentët e rinj të njihen me strukturën e programit, stafit akademik, ambienteve universitare dhe shërbimeve në dispozicion. Gjithashtu, institucioni zhvillon në mënyrë periodike takime të hapura me maturanët, vizita në shkolla të mesme, dhe komunikim përmes rrjeteve sociale e faqes zyrtare të UET për të promovuar programet e studimit dhe për të sqaruar kriteret e pranimit dhe veçoritë e çdo programi.</p> <p><i>Ref 5. Rregullore UET; Ref 10.1. Kalendarit akademik 2022-2023; Ref 10.2. Kalendarit akademik 2023-2024; Ref 10.3. Kalendarit akademik 2024-2025</i></p> <p>https://uet.edu.al/</p>
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e RVB-së, rregulloret institucionale dhe takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se UET garanton informimin e plotë dhe të vazhdueshëm të studentëve në lidhje me përparimin akademik, njohjen e krediteve, vlerësimin e dijës dhe procesin e diplomimit. Informacioni është i strukturuar, i qasshëm përmes Zyrës së Këshillimit, Sekretarisë Mësimore, platformës LMS dhe publikimeve institucionale. Studentët informohen në mënyrë të qartë për të gjitha fazat e ciklit të studimeve, përfshirë transferimet, kriteret e vlerësimit dhe</i></p>

	<i>procedurat e diplomimit, duke siguruar transparencë dhe lehtësim të orientimit akademik. Institucioni angazhohet aktivisht në orientimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të studentëve, përmes aktiviteteve informuese dhe udhëzimeve të dedikuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të detajuar për strukturën dhe organizimin e programit të studimit nëpërmjet këshillimit akademik, dokumentacionit zyrtar të nënshkruar në momentin e regjistrimit, kontratës me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit dhe rregulloreve të brendshme. Gjithashtu, gjatë “Javës së Orientimit”, studentët marrin informacion të zgjeruar mbi strukturën e programit dhe procesin akademik në përgjithësi. <i>Ref 5. Rregullore UET, Kreu 8, Neni 36–37, fq. 10 ; Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	UET, Fakulteti dhe Departamenti ndjekin një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet formave të ndryshme, si njoftimet në faqen zyrtare të internetit, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me pedagogët, këshilltarët akademik, përgjegjës të departamentit. Gjithashtu, institucioni vë në dispozicion udhëzues dhe syllabus për çdo lëndë/modul të programit, duke përfshirë objektivat, ngarkesën mësimore, temat javore, literaturën, vlerësimin dhe detyrat. Studentët marrin këtë informacion përmes platformës LMS dhe janë të mirëinformuar për ecurinë e lëndëve dhe përgjegjësitë e tyre. Këto dokumente janë të aksesueshme dhe përmbajnë detaje të hollësishme. <i>Ref 7. Rregullore_MSH_Inxhinieri Ndertimi; Ref 19.1-19.17. Syllabuset e lëndëve; Ref 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref 46.3. UET LMS Guide per studentet</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me kompani të ndryshme, universitete të tjera, dhe institucione vendore e të huaja, institucioni ka krijuar një rrjet partnerësh që ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive praktike dhe orientimin drejt tregut të punës.</p> <p>Studentët informohen mbi mundësitë e punësimit përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe bordeve të tregut të punës. UET organizon evente si Panairi i Punës, aktivitete informuese me punëdhënës dhe mbledhje të hapura nga departamentet.</p> <p><i>Ref 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref 12.1. Bordi i Tregut te Punes_DIA ; Ref 12.3. Poster_Panairi i punës dhe HR CLUB 2022-2024; Ref 12.4. Bashkepunime me biznesin - Projekti 500+; Ref 12.5. Mbledhje e hapur; https://uet.edu.al/neë/punimet-e-studenteve-ne-uet-perballja-e-pare-me-tregun-e-punes/</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni ka siguruar që studentët të kenë qasje të plotë dhe të përditësuar në informacionet që lidhen me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme. Përmes Zyrës së Këshillimit, Tutorëve, Sekretarisë Mësimore dhe platformës LMS, studentët informohen për orarin e mësimave, sesionet e provimeve dhe procedurat e mbrojtjes së diplomave. Takimet me pedagogët kujdestarë dhe komunikimi i vazhdueshëm përmes postës elektronike janë mjete kryesore të përdorura për të garantuar që studentët të jenë të informuar dhe të angazhuar gjatë procesit akademik.</p> <p><i>Ref 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref 46.3. UET LMS Guide per studentet; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni mbi programin i ofrohet studentëve edhe në distancë përmes platformës LMS dhe adresës zyrtare të e-mailit të institucionit. Përmes këtyre mjeteve, studentët njoftohen për ecurinë në lëndë, detyrat, oraret, mësimin në distancë, mesazhe nga pedagogët etj.</p>

	<i>Ref 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref 46.3. UET LMS Guide per studentet; Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UET garanton transparencë dhe akses të plotë në informacion për studentët në lidhje me objektivat formuese, strukturën dhe organizimin e programit të studimit, përmbajtjen e moduleve, rezultatet e pritshme dhe mundësitë e punësimit. Studentët marrin informacion të detajuar përmes dokumentacionit zyrtar, platformës LMS, këshillimit akademik dhe takimeve orientuese. Gjithashtu, institucioni zhvillon aktivitete me aktorë të tregut të punës dhe mbështet punësimin përmes Zyrës së Karrierës dhe rrjeteve të bashkëpunimit me biznese dhe institucione partnere.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>UET mban të dhëna statistikore për çdo program studimi, duke përfshirë cilësinë e hyrje-daljes së studentëve, punësimin pas diplomimit dhe shkallën e përfundimit. Të dhënat janë të detajuara sipas profilit të studentëve dhe janë përfshirë në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (UMIS), që përmban të dhëna që nga fillimi i aktivitetit të institucionit.</p> <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore (SM) verifikuam që mbahej rregjistri i të diplomuarve në vite sipas programeve të studimit. Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave bëhet në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Për 3 vitet e fundit (2022–2025), vihet re një trend në rritje të numrit të studentëve të regjistruar në PS. Nota mesatare e hyrjes qëndron në intervalin 6.2–6.9, ndërsa nota mesatare në dalje është mbi 7.5, duke dëshmuar për një progres të qëndrueshëm gjatë studimeve. Të dhënat regjistrohen dhe përpunohen përmes sistemit UMIS, ndërsa cilësia e daljes monitorohet përmes diplomimeve dhe rezultateve.</p>

Sipa viteve akademikë	Të regjistruar për herë të parë	Të Transferuar	Nota mesatare në hyrje	Total
2022-2023	15	-	6.81	15
2023-2024	25	-	6.58	25
2024-2025	58	3	5.33	61
Total	98	3	-	101

Ref 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin; Ref 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Inxhinieri Ndërtimi

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash" menaxhohet nga sekretaria mësimore e UET-së. Institucioni mirëmban rregjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët ndër vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në rregjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentit, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Konstatuam që rregjistrat ishin të plotësuar në vazhdimësi. Të dhënat ruhen edhe në UMIS dhe përdoren për të ndjekur ecurinë e studentëve dhe për të marrë masa për përmirësim të vazhdueshëm.

Ref 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore; Ref 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Inxhinieri Ndërtimi

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.


UMIS siguron ruajtjen, përditësimin dhe administrimin e të dhënave përmes aksesit të kontrolluar nga personeli përgjegjës. Të dhënat mbi studentët, përfshirë ato mbi financat, aktivitetet, diplomimin dhe bibliotekën, menaxhohen në mënyrë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Ref 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin

GVJ konstaton se Institucioni mbështet menaxhimin e të dhënave mbi studentët përmes një kuadri të mirëpërcaktuar dokumentar dhe procedurash të brendshme të menaxhimit. Dokumentacioni lidhet me regjistrimin, ndjekjen e ecurisë akademike, vlerësimet,

<p>(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>kalueshmërinë, diplomimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete të ndryshme akademike dhe administrative. Zyra e Sekretarisë Mësimore, në bashkëpunim me Zyrën e IT-së dhe të Kujdesit ndaj Studentit, mbledh dhe përpunon informacionin për secilin student në mënyrë të individualizuar.</p> <p>Sipas dokumentit referues “E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)”, çdo student ka një dosje personale elektronike e cila përmban të gjitha të dhënat nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Regjistrat elektronikë administrohen përmes sistemit të brendshëm UMIS, që mundëson ruajtjen dhe aksesin e kontrolluar të informacionit vetëm nga personeli i autorizuar. Ky sistem garanton siguri, transparencë dhe mundësi për auditim dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së të dhënave. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim më kërkesë të saj.</p> <p><i>Ref 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Ref 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, E.I.5.1 – 5.14, fq. 70–71; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni harton dhe përditëson raporte periodike për cilësinë e hyrje-daljes së studentëve në programet e studimit, përfshirë edhe programin Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”. Raportet përfshijnë të dhëna mbi numrin e të regjistruarve, notat mesatare të hyrjes, numrin e të diplomuarve, notat e diplomimit dhe statistikën e punësimit pas diplomimit. Këto të dhëna përpunohen në mënyrë analitike për të reflektuar performancën vjetore dhe për të identifikuar tendencat dhe zonat ku mund të nevojiten ndërhyrje ose përmirësime.</p> <p>Përmes sistemit UMIS, Zyra e Regjistrimit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës administrojnë të dhënat në mënyrë të koordinuar. Në bashkëpunim me Shoqatën Alumni, organizohen sondazhe për gjurmimin e punësimit të studentëve të diplomuar. Të dhënat e mbledhura nga këto burime i shërbejnë institucionit për të marrë vendime të bazuara në evidencë dhe për të orientuar politikën e zhvillimit të mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>Në tabelën përmbledhëse të Cilësisë në hyrje dhe dalje për programin (Ref. Nr. 27), për periudhën 2022–2025, evidentohet një rritje progresive e numrit të të regjistruarve, si dhe një rritje e qëndrueshme e notës mesatare në dalje, që dëshmon për përmirësim në procesin mësimor.</i></p>



	Ref 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin; Ref 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Inxhinieri Ndërtimi; Vizita në institucion			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UET ka një sistem të mirëstrukturuar të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave studentore përmes platformës UMIS. Të dhënat mbuloohen nga momenti i regjistrimit deri në diplomim dhe përfshijnë elementë të profilit akademik, përfshirë notën mesatare në hyrje dhe dalje, progresin akademik, si dhe ndjekjen e punësimit pas diplomimit. Zyra e Sekretarisë Mësimore mban regjistra të detajuar dhe bashkëpunon me Zyrën e IT-së dhe atë të Karrierës për garantimin e integritetit dhe përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave. Për 3 vitet e fundit, evidentohet rritje e ndjeshme në numrin e studentëve të regjistruar në PS. Institucioni përdor këto të dhëna për monitorim, raportim analitik dhe përmirësim të vazhdueshëm të programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UET ka struktura funksionale që sigurojnë përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, siç janë Këshilli i Studentëve, Senati Akademik, Këshilli i Etikës dhe Komiteti Këshillimor për Standardet dhe Cilësinë (KSBC). Në përbërje të këtyre strukturave ka përfaqësues studentorë me rol të njohur në procesin e diskutimeve dhe vendimmarrjes. Mbledhjet e departamenteve zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe janë të hapura për përfaqësuesit e studentëve. Ref 5. Rregullore UET, Neni 24, 27 dhe 32; Ref 38.1. mbledhje te hapura me studente
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose	Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi që përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit akademik realizohet përmes aktiviteteve të rregullta të zhvilluara nga departamentet, përmes

<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>diskutimeve të drejtpërdrejta, pyetësorëve online, dhe fokus-grupeve të organizuara për të marrë opinionet dhe perceptimet e studentëve mbi procesin mësimor. Këto të dhëna përpunohen dhe adresohen përmes raporteve analitike që përdoren në përmirësimin e programeve. Në rastin konkret, një përfaqësues i studentëve të programit MSc Inxhinieri Ndërtimi është pjesë e GVB-së për këtë program.</p> <p><i>Ref 5. Rregullore UET; Ref 30.14. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; Vizita ne Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV si dhe vizita ne institucion, u konstatua se njësia përgjegjëse per programin e studimit, Departamenti, angazhon studentët përmes organizimit të fokus-grupeve, mbledhjeve të hapura dhe sondazheve për matjen e cilësisë së mësimdhënies. Sugjerimet e studentëve merren në konsideratë gjatë rishikimit të përmbajtjes së lëndëve, metodave të vlerësimit dhe mënyrave të komunikimit. Kjo përfshirje siguron që zëri i studentëve të jetë i pranishëm.</p> <p><i>Ref 12.5. Mbledhje e hapur; Ref 5. Rregullore UET; Ref 30.14. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve ; Vizita ne Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Institucioni siguron transparencë në procesin e vlerësimit përmes përcaktimeve në rregullore dhe në syllabuset e lëndëve. Sipas VKM 41/2018 dhe Formatit të Syllabuseve (Ref. Nr. 19.1), janë të përfshira qartësisht komponentët e vlerësimit, pesha e tyre dhe mënyra e vlerësimit. Studentëve u garantohej e drejta për të kërkuar rishikim të vlerësimeve në rast të pakënaqësive, përmes komisioneve të posaçme. Formularët për ankesa janë në dispozicion dhe procesi i apelimit është i përcaktuar qartë.</p> <p><i>Ref. 19.1. Formatit i Syllabuseve (shqip/anglisht) – VKM 41/2018 ; Ref. 40.2. Formular për ankesat e studentëve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB, dokumentacionin mbështetës dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se UET garanton përfshirjen aktive dhe të strukturuar të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Studentët janë pjesë e Këshillit të Studentëve, Senatit Akademik, Këshillit të Etikës dhe KSBC-së, ku ushtrojnë funksionin e përfaqësimit në mënyrë të organizuar dhe të rregullt. Institucioni siguron pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të</i></p>



	<i>studentëve në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, përmes fokus-grupeve, pyetësorëve periodikë dhe mbledhjeve të hapura, duke reflektuar në mënyrë të dokumentuar sugjerimet e tyre. Po ashtu, janë të përcaktuara qartë procedurat për rishikimin dhe ankimimin e rezultateve të vlerësimit, duke garantuar transparencë, barazi dhe respektim të drejtave të studentëve në çdo fazë të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se pranë UET funksionon një njësi e posaçme për shërbimin e informimit dhe kujdesit ndaj studentëve – Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit – që mbulon të gjithë ciklin e studimeve të studentit, nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Në bashkëpunim me sekretarinë mësimore dhe strukturat akademike, kjo zyrë ofron orientim dhe ndihmë për çdo çështje që ka të bëjë me përparimin dhe mirëqenien studentore. <i>Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UET ka ngritur një sistem të integruar shërbimi për studentët që përfshin Zyrën e Pranimeve, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve, Sekretarinë Akademike, Koordinatorët e Departamenteve dhe sistemin elektronik UET LMS. Përmes këtyre strukturave studentët informohen për çdo aspekt të rëndësishëm që lidhet me përmbajtjen, organizimin dhe ndjekjen e programit të tyre të studimit. <i>Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e	GVJ konstaton se Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron këshillim individual, informon mbi mundësi praktike dhe punësimi, dhe

<p>këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>mban kontakte të vazhdueshme me studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Kjo zyrë organizon gjithashtu aktivitete informuese, trajnime dhe evente me biznese dhe punëdhënës për të ndihmuar studentët të lidhen me tregun e punës dhe të orientojnë zgjedhjet e tyre pas diplomimit.</p> <p><i>Ref. 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit Ref. 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore Ref. 55.1. Kalendar i aktiviteteve per vitin akademik 2023-2024 Ref. 55.2. Kalendar i aktiviteteve per vitin akademik 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga studimi i DVV, takimi me stafin akademik, administrativ dhe studentët evidentuam se Zyra e Këshillimit të Karrierës bashkëpunon ngushtë me Shoqatën Alumni të UET, dhe përmes saj mbledh të dhëna për gjurmimin e studentëve pas diplomimit, përfshirë nivelin e punësimit dhe vazhdimësinë e studimeve. Kjo ndihmon në përmirësimin e programeve në mënyrë të vazhdueshme. Përmes Bordit të Tregut të Punës pranë Departamenteve, studentët alumni kontribuojnë me sugjerime mbi përmbajtjen e programeve dhe përshtatshmërinë e tyre me nevojat e tregut të punës.</p> <p><i>Ref. 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Inxhinieri Ndërtimi; https://uet.edu.al/neë/uet-alumni-10-vite-me-pas/</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e RVB-së, dokumentet referuese dhe të dhënat nga vizita në institucion, GVJ konkludon se UET përmbush plotësisht kërkesat e këtij standardi. Funksionimi i Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, i përfshirë në një sistem të integruar me strukturat e tjera mbështetëse si sekretaria akademike, UET LMS dhe Shoqata Alumni, siguron mbështetje gjithëpërfshirëse për studentët në aspektin akademik, psikologjik, administrativ dhe profesional. Institucioni ofron gjithashtu shërbime të vazhdueshme informimi për studentët në distancë dhe ka zhvilluar mekanizma për të ndjekur cilësinë e punësimit të të diplomuarve, duke mundësuar përmirësim të vazhdueshëm të ofertës akademike në përputhje me nevojat e tregut të punës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në DVV, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një udhëzues të posaçëm për zhvillimin dhe monitorimin e metodave të mësimdhënies për secilën lëndë/modul. Këto udhëzues, të përfshira në rregulloret institucionale dhe syllabus-et e lëndëve, përmbajnë objektivat, rezultatet e pritshme të të nxënit, literaturën, metodologjinë e vlerësimit dhe peshën e komponentëve. Gjithashtu, janë të integruara edhe metoda aktive të mësimdhënies dhe teknika të vlerësimit të vazhdueshëm. Trajnimet e stafit përfshijnë zhvillimin profesional në aspektet e metodologjisë së mësimdhënies dhe përdorimin e platformës LMS. <i>Ref 5. Rregullore UET; Ref 2. Statuti UET; Ref 19.1. A-III-5-1 Formati i Syllabusit Cikli i pare dhe dyte (shqip)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Bazuar në DVV, GVJ konstaton se Institucioni ka struktura të mirëorganizuara për zhvillimin e mekanizmave të monitorimit të mësimdhënies. Ky proces përfshin instrumente të tilla si: pyetësorë për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut nga studentët, mbledhje të hapura me studentët, si dhe fokus-grupe të organizuara nga KSBC. Të dhënat e mbledhura analizohen në nivel departamenti dhe fakulteti, ndërkohë që reflektimet përmirësuese pasqyrohen në raportet vjetore dhe në përmbajtjen e syllabus-eve.

	<p><i>Ref 5. Rregullore UET ; Ref 30.9. Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset;</i></p> <p><i>Ref 30.14. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve;</i></p> <p><i>Ref 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakti i fokus grupeve; Ref 12.5. Mbledhje e hapur</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët përfshihen rregullisht në procesin e vlerësimit të formave të mësimdhënies dhe vlerësimit përmes pyetësorëve anonimë online. Këta pyetësorë administrohen në fund të çdo semestri për çdo lëndë/modul. UET i jep studentëve mundësinë për të paraqitur ankesat e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes formularëve përkatës online ose në mënyrë fizike. Rrjedhimisht, studentët marrin pjesë në vlerësime që synojnë rritjen e cilësisë në procesin mësimor dhe marrin informacion mbi rezultatet përmes përmbledhjeve që shpërndahen nga departamentet.</p> <p><i>Ref 30.11. Shembull_Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset; Ref 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online; Ref 40.1. Shembull_vlerësimi nga studentët_online; Ref 40.2. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë përfshijnë KSBC-në, Dekanatin dhe Përgjegjësit e Departamenteve. KSBC harton raporte vjetore mbi cilësinë e mësimdhënies në bazë të të dhënave të mbledhura nga studentët dhe mësimdhënësit. Raportet përmbajnë rekomandime konkrete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ndahen me Rektoratin dhe strukturat vendimmarrëse. Këto raporte publikohen dhe shpërndahen brenda institucionit.</p> <p><i>Ref 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref 30.12. Shembull_Relacioni i KSBC mbi silabuset DIT_FIIA; Ref 41. G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik.pdf; Ref 41.1. Folloë Up - G-I-12-1 Formular i vetevlerësimit të performancës së personelit akademik -2024-M Cipi</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit</p>	<p>Institucioni përdor rezultatet e vlerësimeve të studentëve për të promovuar praktikat e mira mësimore. Përmes analizës së rezultateve nga vlerësimet e brendshme dhe online, departamentet dhe strukturat përkatëse ndërmarrin masa për përmirësimin e mësimdhënies. Rezultatet e pozitive ndahen në takime</p>

personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	departamentale dhe shërbejnë si modele për përhapjen e praktikave efektive.			
	<i>Ref 5. Rregullore UET, Kreu 7; Ref 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Inxhinieri Ndërtimi.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në DVV, në rregulloret institucionale dhe në të dhënat e verifikuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se Universiteti European i Tiranës ka ndërtuar një sistem të mirëorganizuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Institucioni ndjek politika të qarta për zhvillimin dhe monitorimin e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit, të cilat zbatohen në nivel lënde/moduli dhe përfshihen në mënyrë të standardizuar në syllabus.</i></p> <p><i>Mekanizmat e vlerësimit përfshijnë studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të dokumentuar përmes pyetësorëve anonimë dhe mjeteve të tjera të vlerësimit, ndërsa rezultatet analizohen dhe përdoren për përmirësim të mëtejshëm. Struktura të dedikuara si KSBC, Departamentet dhe Dekanatet monitorojnë dhe reflektojnë mbi performancën mësimore dhe sigurojnë përhapjen e praktikave të mira në të gjithë institucionin. Raportet e vlerësimit shpërndahen brenda njësite përkatëse dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje të informuar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	UET ka ngritur një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë, në përputhje me strategjinë institucionale dhe me standardet e përcaktuara në dokumentet përkatëse si “Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” dhe “Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2023–2028”. Këto dokumente përshkruajnë në detaje mekanizmat për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, programeve të studimit, vlerësimit të stafit akademik dhe

<p>aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>studentëve, si dhe sistemet informuese që mbështesin procesin e përmirësimit të vazhdueshëm.</p> <p>UET ka ngritur KSBC-në (Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë), i cili funksionon sipas përcaktimeve të manualit të cilësisë dhe Statutit të institucionit. Ky komision koordinon mbledhjen dhe analizimin e të dhënave që merren përmes platformës UET-LMS, vlerësimeve online, mbledhjeve me studentë dhe bordeve të tregut të punës.</p> <p><i>Ref 2. Statuti UET, Neni 11; Ref 5. Rregullore UET, Neni 6 pika 6.1.2.b; Ref 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim për miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise; Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025 Ref 30.3.1. Vendim i Senatit Nr. 15 prot, Datë. 23.12.2022 Për miratimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2023-2028; Ref 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBCQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në kuadër të zbatimit të strategjisë së cilësisë, institucioni ka ngritur struktura të dedikuara për menaxhimin e cilësisë së programeve, përfshirë Zyrën e Cilësisë, Zyrën e Kurikulave dhe KSBC. Këto struktura janë përgjegjëse për zbatimin e mekanizmave të monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Strategjia për sigurimin e cilësisë e miratuar nga Senati përcakton qartë angazhimin institucional për përmirësim të vazhdueshëm dhe ndjekje të ciklit Planifiko-Zbato-Vlerëso-Përmirëso. Komponentët e sistemit janë të mbështetur në dokumente udhëzuese dhe në një platformë funksionale që i lejon institucionit të ndjekë ecurinë në kohë reale.</p> <p><i>Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025; Ref 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref 2. Statuti UET, Neni 11; Ref 5. Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve</p>	<p>UET përdor një sërë treguesish për të matur cilësinë e mësimdhënies, përfshirë vlerësimet e studentëve për pedagogët dhe lëndët, vlerësimet e jashtme të kryera nga ASCAL dhe bordet e jashtme të vlerësimit, si dhe akreditimet ndërkombëtare. Të dhënat analizohen dhe përpunohen nga KSBC dhe ZCS, dhe përfshihen në raportet vjetore të performancës.</p> <p>Studentët marrin pjesë në fokus grupe dhe vlerësime periodike për çdo lëndë, me synimin për të përmirësuar qasjen pedagogjike dhe</p>

<p>analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>për të identifikuar fushat problematike. Të dhënat e mbledhura shërbejnë si bazë për zhvillimin e trajnimeve të stafit dhe për rishikimin e strukturës së lëndëve.</p> <p><i>Ref 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC; Ref 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf; Ref 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref 40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online; Ref 29. Monitorimi i ecurisë së studentëve, diplomimit dhe punësimit të tyre - Inxhinieri Ndërtimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor tregues të strukturuar për të analizuar cilësinë e arritjeve studentore dhe për të identifikuar boshllëqet në arritjet e mësimin. Këto tregues përfshihen në raportet e vlerësimit të KSBC dhe pasqyrohen në planin vjetor të përmirësimit.</p> <p>Mbi bazën e këtyre të dhënave, departamentet përgatisin analiza vjetore për performancën akademike dhe masat për ndërhyrje në rastet kur vërehen devijime nga objektivat formues. Procesi është i dokumentuar dhe vlerësohet nga Zyrat përkatëse me synimin për përmirësim afatgjatë të cilësisë së mësimdhënies dhe përmbajtjes së lëndëve.</p> <p><i>Ref 30.1. Plani veprimit KSBC; Ref 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025; Ref 30.5. Metodologjia e punës së KSBC provimet; Ref 30.10. Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve; Ref 30.13. Metodologjia e punës së KSBC_Fokus Grup; Ref 30.12. Shembull_Relacioni i KSBC mbi silabuset DIT_FIIA; Ref 3. Plani Strategjik UET 2021-2025</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në RVB, referencat zyrtare dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se Universiteti European i Tiranës ka ngritur dhe funksionalizon një sistem të mirëstrukturuar për sigurimin e cilësisë së brendshme të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni zbaton strategji të qarta dhe politika institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, të konkretizuara përmes ngritjes së strukturave të posaçme si KSBC dhe ZCS, hartimit të manualeve dhe udhëzuesve të cilësisë, dhe përdorimit të platformës UET-LMS për vlerësim dhe analizë.</i></p>
	<p><i>Vlerësimi i performancës realizohet në mënyrë të vazhdueshme përmes mekanizmave të brendshëm dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve në vlerësime, fokus grupe dhe forume të hapura. Gjithashtu, institucionit i është nënshtruar procesit të akreditimit</i></p>

	<i>të jashtëm dhe monitorimit periodik nga ASCAL, duke siguruar një përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe evropiane për arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës (UET) ka vendosur një sistem të qartë dhe të dokumentuar për vlerësimin e rregullt të programeve të ciklit të dytë, përmes përgatitjes së raporteve vlerësuese periodike. Këto raporte shqyrtohen dhe miratohen nga strukturat përkatëse (departamenti, drejtues të njësive akademike, Senati Akademik), duke i shërbyer reflektimit mbi arritjet, dobësitë dhe nevojat për përmirësim. Raportet janë gjithashtu pjesë e diskutimeve në nivel Rektorati, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në rishikimin e programeve.</p> <p><i>Ref 30.6. Format raporti për kontrollin e provimeve; Ref 30.5. Metodologjia e punës së KSBC provimet</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin</p>	<p>UET përgatit raporte që përfshijnë rezultatet e pritura dhe ato të arritura në përputhje me objektivat formues. Në këto raporte evidentohen analizat mbi ecurinë e provimeve, përmes formatit të kontrollit të zhvilluar për këtë qëllim. Raportet përmbledhin të dhëna mbi suksesin e studentëve, praktikata efektive të pedagogëve dhe masat korrigjuese për dobësitë. Këto analiza, të detajuara për</p>

<p>e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>çdo modul apo semestër, përdoren për të identifikuar problematikat dhe për të informuar vendimmarrjen mbi cilësinë.</p> <p><i>Ref 30.8. Shembull_Raporte kontrolli për tezat provimet – FIIA_DIT; Ref 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online; Ref 40.1. Shembull_vlerësimi nga studentët_online</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në funksion të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Infrastrukturë Transporti" dhe "Inxhinieri Strukturash", UET aplikon një sërë mjetesh: dëgjime në auditore, vlerësime të detyrave, teste të përfundimit të moduleve, intervista me studentë dhe analiza nga përgjegjësit e departamenteve. Procesi i vlerësimit përfshin aktorë të brendshëm akademikë dhe administrativë dhe zhvillohet periodikisht. Gjithashtu, përfshihen sondazhe me studentët për përmbushjen e objektivave mësimore dhe monitorimi i pjesëmarrjes në mësim.</p> <p><i>Ref 30.2.1. Vendim Senati Nr. 03.1, date. 27.10.2017, Vendim për miratimin e strategjise dhe manualit te cilesise; Ref 30.3.1. Vendim i Senatit Nr. 15 prot, Datë. 23.12.2022 Për miratimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2023-2028</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin</p>	<p>Nëpërmjet sondazheve me diplomantë, studentë, personel akademik e administrativ, si dhe përfaqësues të tregut të punës, UET mbledh vazhdimisht të dhëna për performancën dhe ndikimin e programeve të tij. Këto të dhëna përpunohen në nivel institucional për të rishikuar dhe përmirësuar cilësinë. Raportet me analizat përkatëse i vendosen në dispozicion njëjësive përkatëse për të mbështetur zhvillimin profesional të stafit dhe reflektimin mbi praktikën e mësimdhënies.</p> <p><i>Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025; Ref 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf</i></p>

e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.									
Konkluzione	<i>Bazuar në vlerësimin e kryer, GVJ konkludon se Universiteti Europian i Tiranës ka ngritur një sistem funksional dhe të institucionalizuar për monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë së programeve të ciklit të dytë. Proceset e vlerësimit zhvillohen në mënyrë të dokumentuar, përmes raporteve periodike që përfshijnë rezultatet e pritura dhe ato të arritura, si dhe analizën e dobësive dhe masave për përmirësim. Institucioni përdor një shumëllojshmëri metodash të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përfshirë vlerësimin e mësimit, analizën e detyrave të studentëve, dëgjimet në auditore, intervistat dhe sondazhet me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Këto të dhëna përpunohen në mënyrë të rregullt dhe vihen në funksion të vendimmarrjes për rritjen e cilësisë. Për më tepër, përfshirja aktive e strukturave institucionale dhe angazhimi i personelit akademik dhe administrativ në këtë proces garanton një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e	UET siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm (studentë, personel akademik, administrativ) dhe atyre të jashtëm (punëdhënës, alumni) përmes strukturave si Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) dhe Bordet e Tregut të Punës. Përfshirja në projektet europiane si ENCHASE dhe QAINAL ka nxitur krijimin e mekanizmave të formalizuar për bashkëpunim dhe vlerësim, si edhe për trajnimin e stafit në lidhje me cilësinë.

<p>vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në grupin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të këtij programi studimi, është angazhuar aktivisht edhe një përfaqësuese e studentëve.</p> <p><i>Ref 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf; Ref 30.18. Fisha e projektit Enchase; Ref 30.19 Fisha e projektit QainAL; Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ, nisur nga DVV, vëren se vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në nivel institucional por edhe njësie bazë dhe kryesore, ka shërbyer për të përcaktuar objektivat të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara në tërësi e pasqyruar kjo edhe në hartimin e objektivave të zhvillimit strategjik institucional dhe të njësisë kryesore.</p> <p>Në UET, detyrat dhe përgjegjësitë janë të specifikuar për çdo aktor të përfshirë. Studentët janë të angazhuar përmes përfaqësuesve në struktura institucionale, ndërsa stafi akademik përmes rolit të tyre në KSBC dhe grupet e punës për cilësinë. UET ofron trajnime dhe udhëzime për të gjithë të përfshirët, duke forcuar ushtrimin e rolit të tyre në vlerësimin e brendshëm.</p> <p><i>Ref 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, Sesioni 2, pika 4.3; Ref 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në UET, përfshirja e njësisë bazë është e formalizuar nëpërmjet përfaqësuesve në komisionet përkatëse, si dhe angazhimit të drejtuesve të departamenteve dhe përgjegjësve të programeve të studimit. KSBC përfshin përfaqësues nga çdo fakultet dhe departament, si dhe nga grupet e studentëve dhe personeli administrativ, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse.</p> <p><i>Ref 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë</p>	<p>UET ka parashikuar kriteret e qarta për përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, të bazuara në kompetenca, paanësi dhe përvojë. Respektohet integriteti akademik përmes zbatimit të Kodit të Etikës së institucionit dhe krijimit të një ambienti të barabartë për të gjithë aktorët e përfshirë. Procesi është transparent dhe monitorohet nga instanca të pavarura institucionale.</p>


çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<i>Ref 16. A.II. Kodi i Etikës; Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>UET angazhon ekspertë të jashtëm në vlerësimin e brendshëm të cilësisë, veçanërisht përmes bashkëpunimit me Bordin e Tregut të Punës. Ekspertët kontribuojnë me analiza objektive mbi përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut dhe japin rekomandime për përmirësim. Gjithashtu, pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare ka sjellë shkëmbim praktikash me institucione partnere.</p> <p><i>12.1. Bordi i Tregut te Punes_DIA; Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe praktikat e implementuara nga Universiteti European i Tiranës (UET), konstatohet se institucioni ka ndërtuar dhe zbatuar një sistem të strukturuar, gjithëpërfshirës dhe funksional për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Në mënyrë të vazhdueshme dhe të dokumentuar, përmes Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC), bordeve të tregut të punës, përfaqësuesve të studentëve dhe projekteve ndërkombëtare si ENCHASE dhe QAINAL, UET garanton pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Struktura të qarta përgjegjësie, rregullore të detajuara dhe mekanizma mbështetës institucionalë ndihmojnë në funksionimin efektiv të këtij sistemi.</i></p> <p><i>Institucioni ka parashikuar qartë përgjegjësitë e çdo aktori të përfshirë, ka krijuar hapësira të barabarta për kontribut paanësor dhe transparent, si dhe ka përfshirë ekspertë të jashtëm në mënyrë të rregullt për të pasuruar procesin e vlerësimit. Kodi i Etikës dhe strategjitë për sigurimin e brendshëm janë dokumente kyçe që orientojnë integritetin dhe profesionalizmin në këto procese.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë
Tel : +355 (04) 222-43423

Web site : www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>UET ka ngritur një kuadër të qartë rregullator që siguron publikimin dhe transparencën e të gjitha veprimtarive që lidhen me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Këto informacione publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe përputhen me parimet e etikës akademike, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit të studentëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar.</p> <p><i>Ref 16. A.II. Kodi i Etikës</i> <i>Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025</i> https://uet.edu.al/en/raporte-vleresimi/</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>UET publikon raportet e vlerësimit të brendshëm (RVB) në platformën e tij, duke respektuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke siguruar që informacionet të jenë të aksesueshme dhe të qarta për të gjithë aktorët e përfshirë. Procesi i publikimit monitorohet për përputhshmëri me normat ligjore dhe etike.</p> <p><i>Ref 16. A.II. Kodi i Etikës</i> <i>Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025</i> https://uet.edu.al/en/raporte-vleresimi/</p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Rezultatet e vlerësimeve të kryera nga KSBC shoqërohen në mënyrë të rregullt me plane të qarta masash për përmirësimin e cilësisë. Këto plane diskutohen në nivel departamenti, në bashkëpunim me stafin akademik, duke identifikuar problematikat dhe duke propozuar zgjidhje të bazuara në analiza të detajuara. Masat miratohen nga instancat drejtuese dhe përfshihen në raportet vjetore të cilësisë.</p> <p><i>Ref 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025; Ref 18. Plan veprimi për rekomandimet e vba_MSH Inxhinieri Ndërtimi (4)</i></p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	<p>UET ka krijuar mekanizma të qartë për të vlerësuar efektivitetin e veprimtarive të SBC-së, përmes "kontrollit të kryqëzuar" (cross-</p>

<p>efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>check) që përfshin njësitë akademike, departamentet, grupet e lëndëve dhe koordinatorët e programeve. Ky proces i ndërthurur i siguron një verifikim të shumëfishtë të përputhshmërisë së zbatimit të masave me objektivat e përcaktuara për përmirësim.</p> <p><i>Ref 2. Statuti UET, Nenët 11, 16, 20.5, 20.6; Ref 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UET angazhohet vazhdimisht në informimin dhe përfshirjen e stafit dhe studentëve në çështje të cilësisë përmes veprimtarive të rregullta si: javët e orientimit, mbledhjet e Asamblesë së Pedagogëve, trajnime dhe botime në platformën LMS dhe në faqen zyrtare. Këto aktivitete synojnë rritjen e ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mësimore dhe menaxheriale.</p> <p><i>Ref 33. Të dhëna për trajnimet profesionale; Ref 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë; Ref 46.1. Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS; Ref 46.2. UET LMS Guide per pedagogun; Ref 46.3. UET LMS Guide per studentet</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe praktikave të zbatuara nga Universiteti European i Tiranës (UET), konstatohet se institucioni ka ngritur një sistem të konsoliduar dhe transparent për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e Standardit VI.5.</i></p> <p><i>UET ka siguruar një kuadër të qartë politik dhe rregullator për organizimin dhe funksionimin e veprimtarive të cilësisë, të cilat janë të dokumentuara, publike dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët dhe aktorët e tjerë të interesuar. Publikimi i rezultateve të vlerësimit bëhet në përputhje me etikën akademike dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri institucionale.</i></p> <p><i>Institucioni shoqëron çdo proces vlerësimi me plane konkrete për përmirësim dhe e vlerëson në mënyrë të vazhdueshme efektivitetin e masave të marra. Gjithashtu, UET organizon rregullisht veprimtari ndërgjegjësuëse dhe informuese për stafin akademik dhe studentët, duke krijuar një kulturë të brendshme cilësie që mbështet përmirësimin afatgjatë të programeve të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/ i Nivelit të Dytë “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile “Inxhinieri Struktura” dhe “Infrastrukturë Transporti” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “UET”

Pikat e forta dhe afirmime

a. Pika të forta

- 1) Programi i Studimit Master i Shkencave “*Inxhinieri Ndërtimi*” është bërë tërheqës për arritjet në profilin e “*Inxhinieri Struktura*” por edhe në “*Infrastrukturë Transporti*. Kërkesa në rritje e studentëve për ta ndjekur këtë Program Studimi është një tregues bindës dhe në përputhje me objektivat e Universitetit UET për këtë Program Studimi.
- 2) Programi i Studimi Master i Shkencave “*Inxhinieri Ndërtimi*” ka krijuar identitetin e vet me infrastrukturë funksionale, me një bazë didaktike shumë të mirtë, me mundësi të plota për zhvillimin jo vetëm të procesit mësimor por edhe atij kërkimor e shkencor, ku studentët edhe personeli akademik ndjehen të motivuar.
- 3) Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, referuar jo vetëm dokumentacionit por edhe vlerësimeve nga studentët, e zhvillon aktivitetin e tij në plotësim të kërkesave e detyrimeve kontraktuale në plotësim të nevojave institucionale për rritjen e cilësisë.
- 4) Plani mësimor i Programit të Studimit Master i Shkencave “*Inxhinieri Ndërtimi*” është hartuar në mënyrë të tillë që të ketë një produkt të formuar shumë mirë teorikisht e praktikisht, me perspektivë edhe për të zgjeruar pjesëmarrjen në aktivitete kërkimore e shkencore në projekte, si dhe në tregun e punës.
- 5) Rekrutimi i kontigjenteve Bachelor në “*Inxhinieri Ndërtimi*” për në programin Master i Shkencave në “*Inxhinieri Ndërtimi*” me dy profile, është një tregues i rëndësishëm si për

angazhimin e studentëve ashtu edhe për ngritjen cilësore e profesionale të personelit akademik.

- 6) Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor për Programin e Studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” janë të bollshme, të përshtatshme, të paisura dhe inkurajuese për rritjen e pjesëmarrjes dhe përqëndrimin aktiv të studentëve gjatë leksioneve/seminareve etj. Angazhimi institucional për të zgjeruar ambientet egzistuese me hapsira të reja, është një tregues esencial për perspektivën në rritje të kërkesave të procesit mësimor e kërkimor në UET; por edhe për Programin e Studimit Master i Shkencës në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile.
- 7) Universiteti UET për Programin e Studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, ka një bashkëpunim të frytshëm me shumë institucione e kompani brenda dhe jashtë vendit; por edhe me specialistë ekspertë të fushës së inxhinierisë së ndërtimit. Ky bashkëpunim konkretizohet edhe me rritjen e kërkesave për kryerjen jo vetëm të paraktikave profesionale të studentëve por edhe për mobilitetet e personelit akademik dhe studentëve.
- 8) Politikat instucionale të Universitetit UET edhe për programin mësimor Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile konsiderojnë arritjet, adresojnë problematikat dhe hartojnë politika që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në të gjitha aktivitetet.

b. Pika të dobta

- 1) Fondi i bibliotekës për këtë program studimi duhet të pasurohet me literaturë jo më të vjetër se 5 (pesë) vitet e fundit. (Standardi II.4, kriteri 5). Edhe pse literatura që përdor stafi akademik është e viteve të fundit, mungesa e kopjeve gjendje në bibliotekën e institucionit, e bën të vështirë konsultimin e studentëve me literaturën e rekomanduar. Lista e literaturës e rekomenduar në Follow-up është relativisht e vjetër; sipas listës së 31 teksteve, libri më i ri është “Mechanics of materials”, Fifth edition, 2009.; ndërsa libri më i vjetër “Applied hydraulics in engineering”, 1963.
- 2) Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës ka në përbërje të tij 19 MSc, punonjës të punësuar si PAE, prej të cilëve 5 janë nga programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi. GVJ vlerëson, që institucioni në planet e tij të parashikojë edhe hapjen e shkollës së doktoraturës ku të përfshijë sa më parë jo vetëm stafin PAE me gradën Msc por edhe nxitjen e studentëve që mbarojnë këtë program studimi, në përmbushje të detyrimit ligjor të saksionuar në ligjin 80/2015, neni 59, pika 6 (Standardi IV.5, kriteri 2).
- 3) Mobiliteti i studentëve në programin Master i Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi” me dy profile “Inxhinieri Struktura” dhe Infrstrukturë Transporti” është i varfër për të mos thënë se ai nuk ka funksionuar.

Rekomandime

- 1) Për programin e studimit në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy profile të përditësohet fondi i bibliotekës së institucionit për studentët e pedagogët me tekste të rekomanduara në syllabuset e lëndëve me literaturë jo më të vjetër se 5 (pesë) vitet e fundit. (Standardi II.4, kriteri 5).
- 2) Të riformulohet plani mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" sipas dy profileve "Inxhinieri Struktura" dhe "Infrastrukturë Transporti" veçmas njëri nga tjetri, ku të jenë parashikuar edhe lëndët me zgjedhje për sejcilin profil studimi.
- 3) Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy profile të parashikojë edhe mobilitete për studentët e tij.
- 4) Të vendoset në funksionim sa më parë laborator i ngritur për këtë program studimi me orëditë e nevojshme dhe të hartohet një plan i qartë për seancat laboratorike që do të kryhen, duke garantuar akses të rregullt për studentët. (Standardi VI.2, kriteri 3)

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Civil Engineering." provided by the Higher Education Institution "UET."

Strengths and affirmations

- 1) The Master of Science Study Program "Civil Engineering" has become attractive for its achievements in the profile of "*Structure Engineering*" but also in "*Transport Infrastructure*". The growing demand of students to follow this Study Program is a convincing indicator and in line with the objectives of UET University for this Study Program.
- 2) The Master of Science Study Program "Civil Engineering" has created its own identity with a functional infrastructure, with a very good didactic basis, with full opportunities for the development not only of the teaching process but also of the scientific research process where students and academic staff feel motivated.
- 3) The effective and contracted academic staff engaged in this study program, referring not only to the documentation but also to the assessments by students, develops its activity in fulfillment of the contractual requirements and obligations, in fulfillment of the institutional needs for quality improvement.

- 4) The curriculum of the Master of Science Study Program "Civil Engineering" has been designed in such a way as to have a very well-formed product theoretically and practically, with the prospect of expanding participation in research and scientific activities in projects, as well as in the labor market of his choice.
- 5) The recruitment of Bachelor contingents in "Civil Engineering" for the Master of Science in "Civil Engineering" program with two profiles is an important indicator both for the engagement of students and for the qualitative and professional development of academic staff.
- 6) The environments where the teaching process takes place for the Master of Science in "Civil Engineering" Study Program are spacious, suitable, equipped and encouraging for increasing the participation and active concentration of students. The institutional commitment to expand the existing facilities with new spaces is an essential indicator for the growing perspective of the demands of the teaching and research process at UET, but also for the Master of Science in "Civil Engineering" Study Program further improvement of quality in all activities.
- 7) UET University, also for the Master of Science in "Civil Engineering" Study Program, has a fruitful cooperation with many institutions and companies inside and outside the country; but also, with expert specialists in the field of civil engineering. This cooperation is also concretized with the increasing demands for the performance not only of students' professional practices but also for the mobility of academic staff and students.
- 8) The institutional policies of UET University also for the Master of Science in "Civil Engineering" study program with two profiles consider achievements, address problems and draft policies that aim to further improve quality in all activities.
- 9) Although the literature used by the academic staff is recent, the lack of such copies in the institution's library makes it difficult for students to consult the recommended literature. Even the literature recommended in the Follow-up is relatively old; according to the list of 31 texts, the newest book is "Mechanics of materials", Fifth edition, 2009.; while the oldest book is "Applied hydraulics in engineering", 1963. The library fund for this study program should be enriched with literature no older than the last 5 (five) years. (Standard II.4, criterion 5).

Weaknesses

- 1) The library fund for this study program should be enriched with literature no older than 5 (five) years. (Standard II.4, criterion 5). Although the literature used by the academic staff is recent, the lack of copies in the institution's library makes it difficult for students to consult the recommended literature. The list of recommended literature in the Follow-up

is relatively old; according to the list of 31 texts, the newest book is "Mechanics of materials", Fifth edition, 2009.; while the oldest book is "Applied hydraulics in engineering", 1963.

- 2) The Faculty of Engineering, Informatics and Architecture has 19 MSc employees employed as PAE, of which 5 are from the Master of Science in Civil Engineering study program, GVJ estimates that the institution should also foresee in its plans the opening of a doctoral school where it would include as soon as possible not only PAE staff with the MSc degree but also students who graduate from these study programs, in fulfillment of the legal obligation stipulated in Law 80/2015, Article 59, point 6 (Standard IV.5, criterion 2).
- 3) The mobility of students in the Master of Science program in "Civil Engineering" with two profiles "Structural Engineering" and "Transport Infrastructure" is poor, not to say that it has not functioned.

Recommendation

- 1) For the study program in "Civil Engineering", the library fund of the institution for students and teachers should be updated with new textbooks in accordance with the textbooks recommended in the subject syllabi with literature no older than 5 (five) years. (Standard II.4, criterion 5).
- 2) To reformulate the curriculum for the Master of Science in "Civil Engineering" study program according to the two profiles "Structural Engineering" and "Transport Infrastructure" separately from each other, where elective courses for each study profile should also be provided.
- 3) The Master of Science in "Civil Engineering" study program with two profiles should also provide for mobility for its students.
- 4) To put into operation as soon as possible the laboratory established for this study program with the necessary furniture and to draft a clear plan for the laboratory sessions to be conducted, guaranteeing regular access for students. (Standard VI.2, criterion 3)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X